



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06/IA024

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Emilio Gati  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 27 dhjetor 2022

**Gjuha origjinale:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim në lidhje me Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Aleks Uajting

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit:**  
Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Viktimave:**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Kadri Veselit:**  
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit:**  
Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:**  
Venkatesvari Alagenda

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)<sup>1</sup> bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim katër apelet e parashtruara më 8 shtator 2022 (bashkërisht, “apelet”) nga z. Hashim Thaçi (“Thaçi”),<sup>2</sup> z. Kadri Veseli (“Veseli”),<sup>3</sup> z. Rexhep Selimi (“Selimi”)<sup>4</sup> dhe z. Jakup Krasniqi (“Krasniqi”)<sup>5</sup> (bashkërisht, “të akuzuarit” ose “Mbrojtja”), kundër “Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar” (“Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>6</sup> Më 19 shtator 2022 dhe më 21 shtator 2022, Mbrojtësi i Viktimave<sup>7</sup> dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),<sup>8</sup>

---

<sup>1</sup> IA024/F00001, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 31 gusht 2022.

<sup>2</sup> IA024/F00002, Apel i Thaçit kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar, 8 shtator 2022 (“Apeli i Thaçit”).

<sup>3</sup> IA024/F00004, Apel i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar (F00854), 8 shtator 2022 (“Apeli i Veselit”).

<sup>4</sup> IA024/F00003, Apel i Mbrojtjes së Selimit kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar, 8 shtator 2022 (“Apeli i Selimit”).

<sup>5</sup> IA024/F00005, Apel i Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar, 8 shtator 2022 (konfidencial) (“Apeli i Krasniqit”).

<sup>6</sup> F00854, Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar, 24 qershor 2022 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

<sup>7</sup> IA024/F00008, Përgjigje e Mbrojtësit të Viktimave ndaj Apeleve të Mbrojtjes kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar, 19 shtator 2022 (“Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave”).

<sup>8</sup> IA024/F00013, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apeleve të Mbrojtjes kundër Vendimit Kornizë për Kontaktet me Dëshmitarë (F00854), 21 shtator 2022 (konfidenciale) (“Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së”). Më 16 shtator 2022, Paneli i Apelit e ndryshoi afatin dhe kufirin e numrit të lejuar të fjalëve për ZPS-në për të dorëzuar një përgjigje përmbledhëse ndaj Apeleve. Shih IA024/F00007, Vendim mbi Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Zgjatjen e Afatit dhe Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Parashtrimin e Përgjigjes Përmbledhëse, 16 shtator 2022. Shih edhe IA024/F00006, Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit dhe Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për

përkatësisht, u përgjigjën se apelet duhen rrëzuar. Të akuzuarit u kundërpërgjigjën më 27 shtator 2022.<sup>9</sup>

## I. HISTORIKU

1. Më 3 dhjetor 2021, ZPS-ja i kërkoi Gjykatësi i Procedurës Paraprake të miratonte një protokoll për trajtimin e informacionit konfidencial dhe kontakteve me dëshmitarë (“Parashtrimet e ZPS-së” dhe “Protokolli i Propozuar i ZPS-së”).<sup>10</sup>

---

Parashtrimin e Përgjigjes Përmbledhëse ndaj Apeleve të Mbrojtjes kundër Vendimit F00854, 14 shtator 2022.

<sup>9</sup> IA024/F00016, Kundërpërgjigje Përmbledhëse e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjeve të Mbrojtësit të Viktimave dhe ZPS-së ndaj Apeleve të Mbrojtjes kundër Kornizës për Kontaktet me Dëshmitarë (IA024/F00008 & IA024/F00013), 27 shtator 2022 (konfidenciale) (“Kundërpërgjigja e Thaçit”); IA024/F00018, Kundërpërgjigje Përmbledhëse e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjeve të Mbrojtësit të Viktimave dhe ZPS-së ndaj Apelit të saj kundër Vendimit Kornizë për Kontaktet me Dëshmitarë, 27 shtator 2022 (konfidenciale) (“Kundërpërgjigja e Veselit”); IA024/F00017, Kundërpërgjigje Përmbledhëse e Selimit ndaj Përgjigjes së Mbrojtësit të Viktimave, KSC-BC-2020-06/IA024/F00008, dhe Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë, KSC-BC-2020-06/IA024/F00013, 27 shtator 2022 (konfidenciale) (“Kundërpërgjigja e Selimit”); IA024/F00015, Kundërpërgjigje Përmbledhëse e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjeve të Prokurorisë dhe Mbrojtësit të Viktimave ndaj Apelit të Mbrojtjes kundër Vendimit Kornizë, 27 shtator 2022 (konfidenciale) (“Kundërpërgjigja e Krasniqit”) (bashkërisht, “Kundërpërgjigja e Mbrojtjeve”). Më 22 shtator 2022, Paneli i Apelit ndryshoi afatin dhe numrin e lejuar të fjalëve për të akuzuarit për dorëzimin e kundërpërgjigjeve përmbledhëse ndaj Përgjigjes së Mbrojtësit të Viktimave dhe Përgjigjes Përmbledhëse të ZPS-së. Shih IA024/F00014, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kundërpërgjigje, 22 shtator 2022. Shih edhe IA024/F00009, Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit për Zgjatje të Afatit dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Mbrojtësit të Viktimave ndaj Apeleve të Mbrojtjes (IA024/F00008), 20 shtator 2022; IA024/F00010, Parashtrim i Mbrojtjes së Selimit për Bashkim me Kërkesën KSC-BC-2020-06/IA024/F00009, 21 shtator 2022; IA024/F00011, Parashtrim i Veselit për Bashkim me Kërkesën e Krasniqit IA024-F00009, 21 shtator 2022; IA024/F00012, Parashtrim i Mbrojtjes së Thaçit për Bashkim me Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për Zgjatje të Afatit dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Mbrojtësit të Viktimave ndaj Apeleve të Mbrojtjes (IA024/F00008), 21 shtator 2022.

<sup>10</sup> F00594, Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë, 3 dhjetor 2021.

2. Më 10 dhjetor 2021, Mbrojtësi i Viktimave,<sup>11</sup> dhe më 15 dhjetor 2021, Mbrojtja, iu përgjigjën Parashtrimeve të ZPS-së.<sup>12</sup> Më 17 dhjetor 2021, ZPS-ja dorëzoi Listën e Dëshmitarëve të saj si shtojcë të Dosjes Paraprake.<sup>13</sup>

3. Më 3 shkurt 2022, sipas një urdhri të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,<sup>14</sup> Zyra Administrative dorëzoi parashtrimet e veta në lidhje me Protokollin e Propozuar të ZPS-së.<sup>15</sup> Më 14 shkurt 2022, ZPS-ja,<sup>16</sup> Mbrojtësi i Viktimave<sup>17</sup> dhe Mbrojtja u

---

<sup>11</sup> F00605, Përgjigje e Mbrojtësit të Viktimave ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë, 10 dhjetor 2021.

<sup>12</sup> F00625, Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë, 15 dhjetor 2021; F00626, Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitar, 15 dhjetor 2021; F00627/RED, Version i Redaktuar Publik i Përgjigjes së Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë, KSC-BC-2020-06/F00627, datë 15 dhjetor 2021, 17 dhjetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 15 dhjetor 2021); F00628, Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë, 15 dhjetor 2021.

<sup>13</sup> F00631/RED/A02/COR/CONF/RED, Version i Korrigjuar i Shtojcës 2 të Versionit të Redaktuar Publik të Parashtrimit të Dosjes Paraprake me Listat e Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale, KSC-BC-2020-06/F00631 të datës 17 dhjetor 2021, 23 maj 2022 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 17 dhjetor 2021, versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 21 dhjetor 2021) (“Lista e Dëshmitarëve e ZPS-së”).

<sup>14</sup> F00650, Urdhër drejtuar Administratores për Parashtrime, 21 janar 2022.

<sup>15</sup> F00679/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë (F00679), 16 shkurt 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 3 shkurt 2022).

<sup>16</sup> F00693, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë, 14 shkurt 2022 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 16 shkurt 2022) (“Përgjigja e Mëtejshme e ZPS-së”).

<sup>17</sup> F00690, Parashtrime të Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave lidhur me Kornizën e ZPS-së për Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarë gjatë Hetimeve, 14 shkurt 2022 (“Përgjigja e Mëtejshme e Mbrojtësit të Viktimave”).

përgjigjen.<sup>18</sup> Përkatësisht më 15 dhe 21 shkurt 2022, Thaçi iu kundërpërgjigj Përgjigjes së Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave<sup>19</sup> dhe Përgjigjes së Mëtejshme të ZPS-së.<sup>20</sup>

4. Më 16 shkurt 2022, me kërkesë së Thaçit,<sup>21</sup> e mbështetur nga të akuzuarit e tjerë,<sup>22</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi datën e një seance dëgjimore në lidhje me aspektet e lindura nga Parashtrimet e ZPS-së.<sup>23</sup> Më 22 shkurt 2022, u zhvillua seanca e parashikuar.<sup>24</sup>

5. Më 21 mars 2022, Thaçi dorëzoi parashtrime plotësuese në lidhje me Protokollin e Propozuar të ZPS-së.<sup>25</sup> ZPS-ja u përgjigj më 28 mars 2022,<sup>26</sup> ndërsa Thaçi u kundërpërgjigj më 1 prill 2022.<sup>27</sup>

6. Më 24 qershor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Kundërshtuar, me të cilin miratoi kërkesën e ZPS-së për miratimin e Protokollit të Propozuar të ZPS-së, me një numër ndryshimesh, dhe miratoi Kornizën për Trajtimin

---

<sup>18</sup> F00691, Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë, 14 shkurt 2022 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 16 shkurt 2022); F00692, Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë, 14 shkurt 2022 ("Përgjigja e Mëtejshme e Thaçit"); F00694, Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë, 14 shkurt 2022 ("Përgjigja e Mëtejshme e Veselit"); F00695, Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë, 14 shkurt 2022 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 21 shkurt 2022).

<sup>19</sup> F00697, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Mëtejshme të Mbrojtësit të Viktimave në lidhje me Kornizën e ZPS-së për Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarë gjatë Hetimeve, 15 shkurt 2022.

<sup>20</sup> F00705, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Administratores në lidhje me Protokollin e Propozuar për Intervistat me Dëshmitarë, 21 shkurt 2022.

<sup>21</sup> Përgjigja e Thaçit, para. 4, 42-43; Përgjigja e Mëtejshme e Thaçit, para. 1, 12-15. Shih edhe Transkriptin, 4 shkurt 2022, f. 861, rreshtat 7-15.

<sup>22</sup> Transkripti, 4 shkurt 2022, f. 862, rreshtat 23-24, f. 863, rreshtat 15-21, f. 864, rreshtat 2-3. Shih edhe Përgjigjen e Mëtejshme të Veselit, para. 16-17.

<sup>23</sup> F00698, Vendim mbi Kërkesën për Mbajtjen e një Seance, 16 shkurt 2022.

<sup>24</sup> Transkript, 22 shkurt 2022 ("Seanca e 22 shkurtit 2022").

<sup>25</sup> F00741, Parashtrime Plotësuese të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Protokollin e Propozuar të ZPS-së për Kontaktet me Dëshmitarë, 21 mars 2022 ("Parashtrimet Plotësuese të Thaçit").

<sup>26</sup> F00754, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve Plotësuese të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Protokollin e Propozuar të ZPS-së për Kontaktet me Dëshmitarë, 28 mars 2022.

<sup>27</sup> F00758, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit në Mbështetje të Parashtrimeve Plotësuese lidhur me Kornizën e Propozuar të ZPS-së për Kontaktet me Dëshmitarë, 1 prill 2022.



e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar (“Korniza”) të cilën palët dhe pjesëmarrësit duhet ta respektojnë në lidhje me të gjitha veprimtaritë e tanishme ose të ardhshme hetimore dhe kontaktet me dëshmitarë.<sup>28</sup>

7. Më 18 korrik 2022, Mbrojtja kërkoi leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar.<sup>29</sup> ZPS-ja u përgjigj më 1 gusht 2022,<sup>30</sup> ndërsa Mbrojtja u kundërpërgjigj më 15 gusht 2022.<sup>31</sup>

---

<sup>28</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 212 (f. 85-91), 213.

<sup>29</sup> F00883, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar, 18 korrik 2022; F00884, Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit për Leje për Apelim të Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar, 18 korrik 2022; F00886, Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar, 18 korrik 2022; F00887/COR, Version i Korrigjuar i Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarë (F00854), 19 korrik 2022 (versioni i pakorrigjuar u dorëzua më 18 korrik 2022). Më 1 korrik 2022, pas një kërkesë të përbashkët të ekipeve të Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ndryshoi afatet për parashtrime dhe për lëshimin e vendimit mbi lejen për apel. Shih F00864, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00854 (Vendimi mbi Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë), 1 korrik 2022, para. 9-11; F00857, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00854 (Vendimi mbi Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë), 29 qershor 2022, para. 1, 7.

<sup>30</sup> F00903, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F00854, 1 gusht 2022; F00904, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Selimit për Leje për Apelim të Vendimit F00854, 1 gusht 2022; F00905, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit F00854, 1 gusht 2022; F00906, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit F00854, 1 gusht 2022.

<sup>31</sup> F00924, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit F00854 (F00905), 15 gusht 2022; F00925, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F00854, 15 gusht 2022; F00926, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Selimit për Leje për Apelim të Vendimit F00854, 15 gusht 2022; F00927, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës për Leje për Apelim të Vendimit F00854 (F00906), 15 gusht 2022 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 22 gusht 2022).

8. Më 26 gusht 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dha leje për apelimin e dhjetë pikave të mëposhtme, nga 28 pika gjithsej për të cilat kishte kërkuar leje për apelim Mbrojtja:<sup>32</sup>

- (a) Nëse masat e incizimit me video dhe të nxjerrjes së intervistave me dëshmitarët (“incizimi dhe nxjerrja”) përbën ndërhyrje të gabuar në privilegjin e komunikimit mbrojtës-klient dhe komprometon të drejtën e të akuzuarit për të kryer hetime lidhur me provat kundër tij (“pika e parë e Thaçit”);
- (b) Nëse Korniza dhe masat e saj përfshihen në kompetencën e Gjykatësit të Procedurës Paraprake sipas nenit 39(11) të Ligjit për të siguruar “kur është e nevojshme” privatësinë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve (“pika e dytë e Thaçit”);
- (c) Nëse sipas dispozitës dhe kushteve të nenit 39(11) të Ligjit Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhej të bënte dallimin midis kategorive të dëshmitarëve të ZPS-së në zbatimin e Kornizës (“pika e katërt e Thaçit”);
- (d) Nëse kërkesa që Mbrojtja të nxjerrë incizimet me audio dhe video të intervistave të saj është në përputhje me praktikën e parashikuar në rregullat 104-111 të Rregullores (“pika e tetë e Thaçit”);
- (e) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri vlerësim të gabuar të bazës ligjore për miratimin e Kornizës (“pika e parë e Veselit”);

---

<sup>32</sup> F00939, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit F00854, 26 gusht 2022 (“Vendimi mbi Lejen për Apelim”), para. 6-9, 94(a). Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi të mos lejonte apelimin për pjesën tjetër të pikave të kërkuara nga të akuzuarit, pra për pikën e tretë, të pestë, të gjashtë, të shtatë, të nëntë, të dhjetë, të njëmbëdhjetë, të dymbëdhjetë, të trembëdhjetë, të katërbëdhjetë dhe të pesëmbëdhjetë të Thaçit, pikën e dytë dhe të tretë të Selimit, pikën e parë, të dytë dhe të katërt të Krasniqit dhe pikën e dytë dhe të tretë të Veselit; shih Vendimin mbi Lejen për Apelim, para. 6-9, 94(b).

- (f) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se nenet 35(2)(f), 39(1) dhe (11) të Ligjit ofrojnë bazën ligjore për Kornizën e cila nuk kërkon që secili dëshmitar ta justifikojë kërkesën e tij sipas rrethanave individuale (“pika e parë e Selimit”);
- (g) Nëse masat e incizimit me video dhe nxjerrjes të intervistave me dëshmitarët nuk janë proporcionale me qëllimet e deklaruara për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ruajtjen e provave dhe se duhet të ishte shqyrtuar mundësia e masave më pak kufizuese për zvogëlimin e rrezikut të identifikuar (“pika e katërt e Selimit”);
- (h) Nëse ishte e gabuar që Vendimi i Kundërshtuar vendosi një kornizë e cila mbulon të gjithë dëshmitarët që synon t’i thërrasë një palë, dhe jo vetëm ata dëshmitarë të cilët kanë nevojë për mbrojtjen e Kornizës (“pika e tretë e Krasniqit”);
- (i) Nëse ishte e gabuar që në Vendimin e Kundërshtuar u konstatua se miratimi i Kornizës ishte i përligjur për mbrojtjen e privatësisë së dëshmitarëve ose për ruajtjen e provave ose kryerjen e shpejtë të procesit (“pika e pestë e Krasniqit”); dhe
- (j) Nëse ishte e gabuar që në Vendimin e Kundërshtuar u konstatua se Korniza nuk shkel të drejtat e të akuzuarve, konkretisht të drejtën e mosinkriminimit të vetes dhe të drejtën për barazi mes palëve (“pika e gjashtë e Krasniqit”).

9. Më 30 nëntor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi se dosja e çështjes do të ishte gati për t’iu kaluar trupit gjykues më 15 dhjetor 2022 dhe Kryetarja



ia caktoi çështjen gjyqësore Trupit Gjykses II.<sup>33</sup> Më 15 dhjetor 2022, dosja e çështjes gjyqësore i kaloi Trupit Gjykses II.<sup>34</sup>

## II. STANDARDI I RISHIKIMIT

10. Paneli i Gjykatës së Apelit zbaton standardin e rishikimit për apelet e ndërmjetme të vendosur në vendimin e tij të parë dhe të zbatuar në vijim.<sup>35</sup>

## III. ASPEKT PARAPRAK

### A. PARASHTRIMET PUBLIKE

11. Paneli i Apelit vëren se Vendimi i Kundërshtuar u protokollua si publik, ndërsa një sërë parashtrimesh të apelit, konkretisht, Apeli i Krasniqit, Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, Kundërpërgjigjja e Thaçit, Kundërpërgjigjja e Veselit, Kundërpërgjigjja e Selimit dhe Kundërpërgjigjja e Krasniqit u protokolluan si konfidenciale.<sup>36</sup> Paneli rikujton se të gjitha parashtrimet e protokolluara në Dhomat e Specializuara duhet të jenë publike, përveç nëse ka arsye të jashtëzakonshme për t'i mbajtur konfidenciale, dhe se palët duhet të dorëzojnë versione të redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve që i dorëzohen Panelit.<sup>37</sup> Paneli vëren gjithashtu se ZPS-ja, Veseli dhe

---

<sup>33</sup> F01131, Njoftim në përputhje me Rregullën 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, 30 nëntor 2022; F01132, Vendim për Caktimin e Trupit Gjykses II, 30 nëntor 2022.

<sup>34</sup> F01166, Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Trupit Gjykses II, 15 dhjetor 2022.

<sup>35</sup> KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020 ("Vendimi mbi Apelin e Gucatit"), para. 4-14. Shih edhe, p.sh., IA009/F00030, Vendim mbi Apelet kundër "Vendimit mbi Mocionet që Ngrënë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara", 23 dhjetor 2021, para. 11.

<sup>36</sup> Krasniqi bën të ditur se apeli i tij është konfidencial sepse u referohet parashtrimeve të protokolluara dhe provave të cilat aktualisht janë të klasifikuara nga Prokuroria si konfidenciale. Shih Apelin e Krasniqit, para. 6. ZPS-ja bën të ditur se përgjigjja e saj u dorëzua si konfidenciale në bazë të rregullës 82(4) të Rregullores, duke iu referuar Apelit të Krasniqit. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 84, poshtëshënimi 189. Të akuzuarit bëjnë gjithashtu të ditur se Kundërpërgjigjet e Mbrojtjes u dorëzuan si konfidenciale në bazë të rregullës 82(4) të Rregullores duke qenë se Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së është konfidenciale. Shih Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 12; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 20; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 2.

<sup>37</sup> Shih, p.sh., IA008/F00004/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021), para. 8-9 (në të cilin palët u nxitën të dorëzonin sa më shpejt versione të redaktuara të parashtrimeve të tyre, pa pritur t'u jepej urdhër për këtë).

Selimi nuk kanë kundërshtim ndaj riklasifikimit si publike, përkatësisht, të Përgjigjes Përmbledhëse të ZPS-së, Kundërpërgjigjes së Veselit dhe Kundërpërgjigjes së Selimit.<sup>38</sup> Rrjedhimisht Paneli urdhëron të akuzuarit dhe ZPS-në të dorëzojnë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të apelit të përmendura më sipër<sup>39</sup> ose të bëjnë të ditur, me anë të një parashtrimi të protokolluar, nëse ato mund të riklasifikohen si publike brenda dhjetë ditëve pas marrjes njoftim për këtë vendim.

#### IV. DISKUTIM

A. NËSE KORNIZA ËSHTË E PËRLIGJUR DHE NË PËRPUTHJE ME KORNIZËN LIGJORE TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA (PIKA B E APELIT TË THAÇIT, PJSËRISHT; PIKA 1 E APELIT TË KRASNIQIT; PIKAT A DHE B TË APELIT TË VESELIT)

12. Paneli i Gjykatës së Apelit gjykon se një pjesë e Pikës B të Apelit të Thaçit (që përkon me pikën e dytë të Thaçit), Pikat A dhe B të Apelit të Veselit (që përkojnë me pikën e parë të Veselit), si edhe Pika 1 e Apelit të Krasniqit (që përkon me pikën e pestë të Krasniqit) kanë ngjashmëri të konsiderueshme, sepse të gjitha kanë të bëjnë me bazën ligjore të Kornizës dhe përrputshmërinë e saj me dispozitat ligjore të Dhomave të Specializuara, si dhe me kompetencat e Gjykatësit e Procedurës Paraprake për të miratuar Kornizën. Rrjedhimisht, këto pika apeli do të shqyrtohen bashkërisht.

##### 1. Parashtrimet e palëve

13. Thaçi dhe Veseli parashtrojnë se Korniza nuk përfshihet në kompetencat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake sipas nenit 39(11) të Ligjit.<sup>40</sup> Në veçanti, Veseli parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që miratoi Kornizën në bazë të

---

<sup>38</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 84; Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 12; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 20.

<sup>39</sup> Konkretisht, Apeli i Krasniqit (IA024/F00005); Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së (IA024/F00013); Kundërpërgjigjja e Thaçit (IA024/F00016); Kundërpërgjigjja e Veselit (IA024/F00018); Kundërpërgjigjja e Selimit (IA024/F00017); Kundërpërgjigjja e Krasniqit (IA024/F00015).

<sup>40</sup> Apeli i Thaçit, para. 41, 44-45; Apeli i Veselit, para. 16, 20-21. Shih edhe Apelin e Thaçit, para. 40, 55; Apelin e Veselit, para. 12; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 7.

neneve 35(2)(f), 39(1) dhe 39(11) të Ligjit, ndërkohë që duhej të ishte mbështetur në nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullën 80 të Rregullores, që janë dispozitat parësore për mbrojtjen e dëshmitarëve.<sup>41</sup> Sipas tij, Korniza është *ultra vires* dhe i jep “një pakufizueshmëri të papranueshme” ushtrimit të diskrecionit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake sipas nenit 39(11) të Ligjit.<sup>42</sup>

14. Gjithashtu, Thaçi, Veseli dhe Krasniqi argumentojnë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se Korniza është *e nevojshme* për të arritur objektivat e mbrojtjes dhe privatësisë së dëshmitarëve, ruajtjes së provave dhe kryerjes së shpejtë të procesit.<sup>43</sup> Më konkretisht, Krasniqi pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bëri vlerësimin nëse Korniza ishte masa më pak kufizuese e mundshme dhe i kërkon Panelit të Apelit ta kryente këtë vlerësim.<sup>44</sup> Sipas mendimit tij, ishin të disponueshme alternativa më të thjeshta dhe më pak ndërhyrëse, të cilat nuk u morën në shqyrtim.<sup>45</sup> Veseli parashtron gjithashtu se masat mbrojtëse nuk mund të jenë të përgjithshme dhe ato duhet të jenë proporcionale me rrezikun e identifikuar dhe të mos cenojnë të drejtat e të akuzuarve.<sup>46</sup>

15. Thaçi dhe Krasniqi theksojnë se fakti që nuk është ngritur asnjë shqetësim për ndërhyrje pas muajsh hetimesh të Mbrojtjes edhe pa ekzistuar Korniza, dëshmon se

---

<sup>41</sup> Apeli i Veselit, para. 9-15, ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 115, 117, 121. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 4-6. Veseli argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk jep arsye pse veprimi jashtë kuadrit të rregullës 80. Shih Apelin e Veselit, para. 16, 18; Kundërpërgjigja e Veselit, para. 8.

<sup>42</sup> Apeli i Veselit, para. 15-16, 20-22. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 7, 10. Veseli shton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkon ta zgjerojë kuptimin e nenit 39(11) të Ligjit. Shih Apelin e Veselit, para. 20, ku i referohet ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-2145-Corr-Red, Public Redacted Version of “Corrected Version of ‘Narcisse Arido’s Document in Support of Appeal Pursuant to Article 81’, (ICC-01/05-01/13-2145-Conf), filed 24 April 2017” (ICC-01/05-01/13-2145-Conf-Corr), filed 8 May 2017, 31 May 2017 (“*Bemba* Defence Filing”), para. 162-166, 180-188.

<sup>43</sup> Apeli i Thaçit, para. 39-40, 43, 45; Apeli i Veselit, para. 14-16; Apeli i Krasniqit, para. 17-34, ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 116-125, 143. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 5, 38; Apeli i Thaçit, para. 55; Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 8-9; Kundërpërgjigja e Krasniqit, para. 5-9. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 10; Kundërpërgjigja e Selimit, para. 5.

<sup>44</sup> Apeli i Krasniqit, para. 20-21, 31-34. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 17, 38.

<sup>45</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 31-32. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 5, poshtëshënimi 8.

<sup>46</sup> Apeli i Veselit, para. 14-15.

Korniza nuk ishte e nevojshme.<sup>47</sup> Sipas mendimit të Krasniqit, fakti që mbrojtësit, të cilët i përmbahen Kodit të Etikës Profesionale (“Kodi i Etikës”),<sup>48</sup> prezumohet se veprojnë me ndershmëri, e bën edhe më tej të panevojshme Kornizën.<sup>49</sup>

16. Mbrojtësi i Viktimave dhe ZPS-ja përgjigjen se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte bazën e duhur ligjore për miratimin e Kornizës, që nuk përbën tejkallim të kompetencave të tij.<sup>50</sup> Mbrojtësi i Viktimave parashtron se nenet 23(1) dhe 39(11) të Ligjit, që rregullojnë aspekte të ndryshme – konkretisht mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve dhe kompetencat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake – nuk dublojnë, por plotësojnë, njëri-tjetrin, pa ndonjë hierarki.<sup>51</sup> Sipas tij, në nenin 23(1) të Ligjit apo në rregullën 80 të Rregullores nuk ka asgjë që kufizon apo përcakton diskrecionin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.<sup>52</sup>

17. Sipas ZPS-së, të akuzuarit nuk e “trajtojnë plotësisht” bazën ligjore mbi të cilën e mbështeti Kornizën Gjykatësi i Procedurës Paraprake, për shembull, sepse nuk marrin parasysh rëndësinë e nenit 39(1) të Ligjit.<sup>53</sup> ZPS-ja argumenton së pari se Korniza “mbështetet fort” në protokolle të ngjashme të Dhomave të Specializuara dhe gjykatave të tjera ndërkombëtare.<sup>54</sup> Ajo parashtron se argumentet e Mbrojtjes nuk qëndrojnë, sepse e interpretojnë në mënyrë tejet kufizuese diskrecionin e gjerë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake sipas nenit 39(1) dhe (11) të Ligjit, që i lejon atij ta

---

<sup>47</sup> Apeli i Thaçit, para. 45; Apeli i Krasniqit, para. 22-23; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 10, 12. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 28, 41; Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 9.

<sup>48</sup> Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-07-Rev1, 28 prill 2021 (“Kodi i Etikës”).

<sup>49</sup> Apeli i Krasniqit, para. 24. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 2, 30; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 10, 12.

<sup>50</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 5, 44-48, 57; Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 24-46. Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse e ZPS-së, para. 13.

<sup>51</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 47.

<sup>52</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 44, 48.

<sup>53</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 25-27, 48. Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse e ZPS-së, para. 29, 32-33.

<sup>54</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 19-20, ku i referohet KSC-BC-2020-07, F00314/A01, Shtojcë e Urdhrit mbi Zhvillimin e Procedurave, 17 shtator 2021 (“Protokolli i Çështjes 07”); ICC, Chambers Practice Manual, Fifth Edition, 25 March 2022, Annex (“Protokolli i GJPN-së”). Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse e ZPS-së, para. 2.

miratojë Kornizën.<sup>55</sup> Në veçanti, ZPS-ja parashtron se, duke qenë se Korniza nuk mbështetet në rregullën 80 të Rregullores, standardi më kufizues i pretenduar nga Mbrojtja nuk zbatohet.<sup>56</sup> Krahas kësaj, ZPS-ja argumenton se të akuzuarit kërkojnë të vlerësojnë elemente të Kornizës në mënyrë të shkëputur dhe nuk marrin parasysh se ajo synon arritjen e objektivave të shumëfishtë.<sup>57</sup> ZPS-ja kundërshton gjithashtu argumentet e Mbrojtjes lidhur me privatësinë e dëshmitarëve, duke theksuar se Korniza ofron mbrojtje më të madhe se Kodi i Etikës.<sup>58</sup> Në fund, sa i takon pretendimit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake veprimi *ultra vires*, ZPS-ja parashtron se nenet e Ligjit mund të akordojnë “kompetenca të ushtrueshme” edhe në mungesë të dispozitave përkatëse në Rregullore dhe mund të shërbejnë si bazë për krijimin e kriterëve përtej asaj që përcaktohet shprehimisht në Rregullore.<sup>59</sup>

18. Thaçi kundërpërgjigjet se qëndrimi i ZPS-së lidhur me nenin 39(1) të Ligjit si bazë e mjaftueshme për zbatimin e Kornizës nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake e bën të tepërt nenin 39(11) të Ligjit, kurse ky i fundit, si dispozita më konkrete, e kufizon autoritetin ligjor të tij për autorizimin e masave të tilla vetëm “kur është e nevojshme”.<sup>60</sup>

19. Në kundërpërgjigjen e tij, Veseli kundërshton interpretimin “tejet formalist dhe të palogjikshëm” që i bën ZPS-ja nenit 39(11) të Ligjit.<sup>61</sup> Ai nënvizon procedurën e parashikuar në rregullën 5 të Rregullores.<sup>62</sup>

---

<sup>55</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 29, 32-33, 37-41, 43-45. Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse e ZPS-së, para. 13-14.

<sup>56</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 30-31, 37, 41, 45.

<sup>57</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 29-30, 33-34. Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse e ZPS-së, para. 13-14, 46.

<sup>58</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 35-36. Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse e ZPS-së, para. 34, 43.

<sup>59</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 40, 44. ZPS-ja argumenton gjithashtu se mbështetja e Veselit në çështjen gjyqësore *Bemba* është pa vend. Shih Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 45.

<sup>60</sup> Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 7-8. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 9.

<sup>61</sup> Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 4-5. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 6, 8.

<sup>62</sup> Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 7. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 10.

20. Krasniqi kundërpërgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka diskrecion në bazë të nenit 39(1) dhe (11) të Ligjit vetëm pasi është përmbushur “standardi i domosdoshmërisë”, të cilin Korniza, sipas mendimit të tij, nuk e përmbush.<sup>63</sup>

21. Thaçi dhe Krasniqi gjithashtu kundërshtojnë parashtrimin e ZPS-së se Korniza “mbështetet fort” në protokolle të ngjashme në Dhomat e Specializuara dhe gjetkë.<sup>64</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

22. Paneli i Gjykatës së Apelit vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e miratoi Kornizën duke u mbështetur në nenet 35(2)(f) dhe 39(1) dhe (11) të Ligjit.<sup>65</sup>

23. Neni 35(2)(f) i Ligjit parashikon që:

Prokurori i Specializuar dhe prokurorët e tjerë në Zyrën e Prokurorit të Specializuar kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për t’i kryer funksionet e detyrës së tij/saj, përfshirë autoritetin për të zhvilluar hetime penale dhe për të marrë përgjegjësi për hetimet penale apo procedurat gjyqësore të reja apo në proces në kuadër të juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuar me këtë ligj. Këto autoritete dhe përgjegjësi përfshijnë:

[...]

f. marrjen e masave të nevojshme, ose bërjen e kërkesës për marrjen e masave të nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e informatave, mbrojtjen e çdo personi ose ruajtjen e provave;

24. Neni 39(1) i Ligjit parashikon që:

Gjyqtari i procedurës paraprake ka kompetencë për ta shqyrtuar aktakuzën, për të vendosur lidhur me parashtrirat paraprake, përfshirë ankesat ndaj aktakuzës dhe juridiksionit, si dhe që të nxjerrë urdhër apo vendim të nevojshëm për të siguruar që rasti të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.

<sup>63</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 5-7, 9-10. Krasniqi pretendon se vlerësimi nëse një masë është “e nevojshme” është kriter edhe për zbatimin e rregullës 80 të Rregullores. Shih Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 8.

<sup>64</sup> Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 3-4; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 3-4. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 9.

<sup>65</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 115, 135. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, f. 1.



25. Neni 39(11) i Ligjit parashikon që:

Kur është e nevojshme, gjyqtari i procedurës paraprake mund të sigurojë mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe të dëshmitarëve, ruajtjen e provave, mbrojtjen e personave dhe informacionit të sigurisë kombëtare ose ruajtjen e pasurive që mund të jenë objekt i sekuestrimit sipas këtij ligji dhe Rregullave të procedurës dhe provave, përfshirë urdhrat për ngrirje të përkohshme, urdhrat për konfiskim të përkohshëm ose masat e tjera të përkohshme.

26. Paneli i Apelit do të trajtojë fillimisht bazën ligjore për miratimin e Kornizës. Duke rikujtuar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gjykuar se neni 35(2)(f) dhe neni 39(1) dhe (11) i Ligjit ofrojnë bazën ligjore për të urdhëruar masa të përgjithshme lidhur me trajtimin e informacionit konfidencial dhe rregullimin e kontakteve me dëshmitarët,<sup>66</sup> Paneli vëren fillimisht se në bazë të nenit 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka diskrecion të miratojë çdo urdhër ose vendim të nevojshëm për të siguruar që çështja të përgatitet siç duhet dhe shpejt për gjykim. Në lidhje me këtë, Paneli vëren se vendimet lidhur me aspekte të administrimit të gjykimit dhe zhvillimin e procedurave përgjithësisht trajtohen si diskrecionale.<sup>67</sup> Po kështu, Paneli vëren se formulimi i nenit 39(11) të Ligjit është lënë i hapur dhe nuk përcakton një listë shteruese të masave që duhen marrë për arritjen, ndër të tjera, të objektivave të mbrojtjes dhe privatësisë së viktimave dhe dëshmitarëve dhe ruajtjes së provave. Paneli konstaton se këto dispozita i japin kompetencë të gjerë diskrecionale Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të miratuar një varg masash për përgatitjen e çështjes për gjykim dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk është i detyruar të miratojë vetëm

---

<sup>66</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 115.

<sup>67</sup> Shih, p.sh., *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-A, Aktgjykim, 19 korrik 2010, para. 39; ICTR, *Kanyarukiga v. Prosecutor*, ICTR-02-78-A, Judgement, 8 May 2012, para. 26; ICTR, *Prosecutor v. Nyiramasuhuko et al.*, ICTR-98-42-A, Judgement, 14 December 2015, para. 68. Po kështu, edhe vendimet që lidhen me mbrojtjen e dëshmitarëve janë konsideruar si vendime diskrecionale. Shih, p.sh., IRMCT, *Prosecutor v. Niyitegeka*, MICT-12-16-R, Decision on Appeals of Decisions Rendered by a Single Judge, 9 August 2017, para. 14. Në raste të tilla, në apel duhet të demonstrohet se paneli i shkallës më të ulët ka bërë gabim të dallueshëm, në kuptimin që vendimi: (i) mbështetet në interpretim të pasaktë të ligjit në fuqi; (ii) mbështetet në një konstatim faktik qartësisht të gabuar; ose (iii) është kaq i padrejtë ose i paarsyeshëm saqë përbën shpërdorim të diskrecionit të panelit të shkallës më të ulët. Shih, p.sh., Vendimin mbi Apelin e Gucatit, para. 14.

masa që janë parashikuar konkretisht në Rregullore. Sipas mendimit të Panelit, Korniza bën pjesë në masat e përgjithshme të cilat Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund t'i miratojë në bazë të këtyre dispozitave ligjore.

27. Megjithëse Paneli pajtohet me Mbrojtjen se neni 23(1) i Ligjit dhe rregulla 80 e Rregullores<sup>68</sup> janë dispozitat kryesore të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara që i dedikohen mbrojtjes së dëshmitarëve, siç u pranua edhe nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,<sup>69</sup> Paneli vëren se sipas nenit 39(11) të Ligjit, edhe mbrojtja e dëshmitarëve është një prej funksioneve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Rrjedhimisht, fakti se masat mbrojtëse duhen urdhëruar në bazë të nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullës 80 të Rregullores nuk përjashton mundësinë e urdhërimit të masave të tjera në bazë të nenit 39(11) të Ligjit, ndër të tjera me qëllim që të sigurohet mbrojtja e dëshmitarëve, sepse kjo është saktësisht kompetencë e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në bazë të kësaj dispozite.<sup>70</sup> Sipas mendimit të Panelit, Mbrojtja nuk ka demonstruar që neni 39(11) i Ligjit nuk mund të funksionojë në mënyrë të pavarur nga neni 23(1) i Ligjit dhe se kjo dispozitë nuk mund të ofrojë bazë ligjore më vete për miratimin e Kornizës. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gaboi që u mbështet në nenin 39(1) dhe (11) të Ligjit, në vend të nenit 23(1) të Ligjit dhe rregullës 80 të Rregullores, për miratimin e Kornizës.

---

<sup>68</sup> Neni 23(1) i Ligjit thotë:

Rregullat Dhomave të specializuara për procedurën dhe provat e parashikojnë mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve, përfshirë sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre. Këto masa mbrojtëse i përfshijnë, por nuk limitohen, mjetet që janë të përcaktuara në nenet 221-226 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligji nr. 04/L-123, nenet 5-13 të Ligjit nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, zhvillimin e procedurave me dyer të mbyllura, paraqitjen e provave me mjete elektronike ose mjete të tjera të veçanta, dhe mbrojtjen e identitetit.

Rregulla 80(1) e Rregullores thotë:

Bazuar në nenin 23(1) të Ligjit, një panel, *proprio motu* ose me kërkesë të një pale, të Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, të një dëshmitari ose, kur është e zbatueshme, të mbrojtësit të viktimave, mund të urdhërojë masa mbrojtëse për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së një dëshmitari, me kusht që masat të jenë në pajtim me të drejtat e të akuzuarit.

<sup>69</sup> Shih Apelin e Veselit, para. 11; Vendimi i Kundërshtuar, para. 121.

<sup>70</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 117.

28. Paneli hedh poshtë argumentin e Mbrojtjes se baza ligjore për Kornizën *duhet* të përcaktohet në Rregullore, sepse ajo ka pasur bazë konkrete që më parë në Ligj. Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se nuk ka rëndësi fakti që dispozitat e Dhomave të Specializuara nuk e parashikojnë shprehimisht Kornizën në vetvete, sepse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka diskrecion të miratojë, në bazë të nenit 39 të Ligjit, masa ose procedura që i konsideron të domosdoshme për çështjen gjyqësore, pavarësisht se nuk përmenden shprehimisht në Rregullore.<sup>71</sup> Në këtë aspekt, Paneli nuk gjykon se ka “zbrazëti ligjore” në Rregullore, sipas rregullës 5 të Rregullores.<sup>72</sup>

29. Rrjedhimisht, Paneli nuk pajtohet me argumentin e Mbrojtjes sipas të cilit Gjykatësi i Procedurës Paraprake tejkaloi autoritetin e tij, veçoi *ultra vires* dhe e zgjeroi kuptimin e nenit 39(11) të Ligjit.<sup>73</sup> Paneli i Apelit hedh poshtë gjithashtu si të pambështetur argumentin e Veselit, sipas të cilit Gjykatësi i Procedurës Paraprake

<sup>71</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 129. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, poshtëshënimi 220, ku i referohet F00099, Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To, 23 nëntor 2020 (“Korniza mbi Nxjerrjet”); F00159, Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat, 4 janar 2021 (“Korniza mbi Kërkesat e Viktimave”).

<sup>72</sup> Shih edhe rregullën 4 të Rregullores dhe nenin 19(2) dhe (3) të Ligjit. *Contra* Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 7. Duke qenë se Rregullorja është instrument për zbatimin e Ligjit dhe, për rrjedhojë, është poshtë tij në hierarki, dispozitat e Rregullores nuk mund të interpretohen se e ngushtojnë fushëveprimin e dispozitave të Ligjit. Shih, p.sh., ICC, *Situation in the Republic of Burundi*, ICC-01/17-9-Red, Public Redacted Version of “Decision Pursuant to Article 15 of the Rome Statute on the Authorization of an Investigation into the Situation in the Republic of Burundi”, ICC-01/17-X-9-US-Exp, 25 October 2017, 9 November 2017, para. 9.

<sup>73</sup> Paneli i Apelit vëren se Veseli në mënyrë të gabuar i referohet “aktgjykimit të apelit” në çështjen *Bemba et al.*, duke parashtruar se Dhoma e Apelit e GJPN-së konstatoi se trupi gjyqësor bëri interpretim të gabuar të “dëshmitar” sipas nenit 70(1)(c) të Statutit të Romës dhe veçoi *ultra vires*, ndërkohë që, në të vërtetë, këto nuk ishin konstatime të Dhomës së Apelit të GJPN-së por parashtrimet e Mbrojtjes në apel. Përkundrazi, madje, Dhoma e Apelit e GJPN-së nuk konstatoi asnjë gabim në arsyetimin e trupit gjyqësor. Shih Apelin e Veselit, para. 20, poshtëshënimi 19, ku i referohet *Bemba* Defence Filing, para. 162-166, 180-188. Shih edhe ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-2275-Red, Public Redacted Judgment on the appeals of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo, Mr Aimé Kilolo Musamba, Mr Jean-Jacques Mangenda Kabongo, Mr Fidèle Babala Wandu and Mr Narcisse Arido against the decision of Trial Chamber VII entitled “Judgment pursuant to Article 74 of the Statute”, 8 March 2018, para. 720-723. Rrjedhimisht, parashtrimet e Veselit në lidhje me këtë aspekt rrëzohen menjëherë sepse shtrembërojnë konstatimet. Shih, p.sh., KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021 (“Vendimi mbi Apelin e Haradinajt”), para. 29.

mbështetet në nenin 39(1) të Ligjit për të krijuar rregulla dhe procedura që tejkalojnë fushëveprimin material të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara.<sup>74</sup>

30. Në lidhje me mbështetjen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në protokollet e miratuara në çështje të tjera gjyqësore në Dhomat e Specializuara dhe gjetkë, Paneli vëren se, megjithëse të akuzuarit vënë në dukje dallimet midis Kornizës dhe Protokollit të GJPN-së,<sup>75</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndonëse konstatoi se Protokollit i GJPN-së ofron “një model të përshtatshëm udhëzues” për Kornizën, nuk pretendoi asnjëherë se këto dy dokumente ishin identike dhe madje pranoi veçantitë e procedurave të ndryshme.<sup>76</sup> Sidoqoftë, Paneli vëren se pjesa më e madhe e masave të Kornizës që kontestohen në apel përfshihen edhe në protokollin e GJPN-së.<sup>77</sup> Gjithashtu, duke pasur parasysh ngjashmëritë midis nenit 39(11) të Ligjit dhe nenit 57(3)(c) të Statutit të Romës,<sup>78</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi me të drejtë se Protokollit i GJPN-së mbështetet në një “bazë ligjore pothuaj identike”.<sup>79</sup> Sa u takon

<sup>74</sup> *Contra* Apeli i Veselit, para. 21.

<sup>75</sup> Shih Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 2, 4; Kundërpërgjigja e Krasniqit, para. 3.

<sup>76</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 126-127. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 131, 199; Seanca e 22 shkurtit 2022, f. 974, rreshtat 6-10.

<sup>77</sup> Veçanërisht, Protokollit i GJPN-së parashikon gjithashtu: (i) një procedurë njoftimi të ngjashme, sipas së cilës pala thirrëse duhet të vërtetojë dhënien e pëlqimit nga dëshmitari që kërkohet të intervistohet; (ii) që dëshmitari mund të zgjedhë që gjatë intervistës të jetë i pranishëm një përfaqësues i palës thirrëse; (iii) që intervistat të incizohen me audio ose video dhe një kopje e incizimeve duhet t'i jepet palës thirrëse. Shih Protokollin e GJPN-së, para. 31-32, 41. Krahas kësaj, megjithëse Protokollit i GJPN-së nuk parashikon mundësinë që pala thirrëse të kërkojë leje nga gjykata për të qenë e pranishme në intervistë kundër parapëlqimit të shprehur të dëshmitarit, Protokollit i GJPN-së parashikon që pavarësisht nga dhënia e pëlqimit nga dëshmitari për t'u intervistuar, pala thirrëse gjithsesi mund ta kundërshtojë kryerjen e intervistës dhe t'i kërkojë gjykatës lëshimin e një vendimi në lidhje me këtë. *Krahaso* Kornizën, para. 212(II)(b) me Protokollin e GJPN-së, para. 42. Gjithashtu, Paneli vëren se megjithëse Protokollit i GJPN-së nuk parashikon që gjykatësit të marrin një kopje të incizimeve të intervistave ose që këto incizime të mund të pranohen si prova me kërkesë të një pale ose *proprio motu* nga gjykatësit, palët nuk i pengon asgjë që të kërkojnë pranimin e tyre si prova.

<sup>78</sup> Neni 57(3)(c) i Statutit të Romës thotë:

Krahas funksioneve të tjera të saj në bazë të këtij Statuti, Dhoma e Procedurës Paraprake:

[...]

(c) kur është e nevojshme, mund të sigurojë mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe dëshmitarëve, ruajtjen e provave, mbrojtjen e personave që janë arrestuar ose paraqiten në përgjigje të fletëthirrjes dhe mbrojtjen e informacionit të sigurisë kombëtare.

<sup>79</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 126.

çështjeve të tjera para Dhomave të Specializuara, Paneli konstaton se fakti që deri më tani nuk janë miratuar korniza të tilla në Çështjen 04<sup>80</sup> dhe Çështjen 05, ndërsa në Çështjen 07 një kornizë e ngjashme u miratua nga Trupi Gjyqësor,<sup>81</sup> nuk është relevant, sepse vendimi për miratimin ose jo të një kornize të tillë bën pjesë në diskrecionin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake (ose të Trupit Gjyqësor), në varësi të rrethanave konkrete të secilës çështjeje gjyqësore.<sup>82</sup>

31. Në lidhje me faktin nëse termi “kur është e nevojshme” e kufizon diskrecionin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për ta miratuar Kornizën vetëm në rrethanat kur ajo është *e nevojshme* për shkak të rreziqeve faktike me të cilat përballen dëshmitarët, Paneli rikujton se Korniza nuk u miratua në bazë të rregullës 80 të Rregullores dhe, rrjedhimisht, standardi i rregullës 80 të Rregullores nuk është i zbatueshëm.<sup>83</sup> Për pasojë, parashtrimet e Mbrojtjes me të cilat kërkon një interpretim më kufizues dhe vlerësim të individualizuar të rrethanave të çdo dëshmitari dhe demonstrimin e ekzistencës së rrezikut, hidhen poshtë si të pavend, sepse një interpretim i tillë ka të bëjë me zbatimin e standardit sipas rregullës 80 të Rregullores, që lidhet vetëm me masat mbrojtëse. Paneli pranon se termi “kur është e nevojshme” vendos kufizim mbi diskrecionin e gjerë që gëzon Gjykatësi i Procedurës Paraprake për të përcaktuar se *kur dhe çfarë lloj* masash janë të përligjura për arritjen e objektivave të përgjithshëm të

---

<sup>80</sup> Trupi Gjyqësor në çështjen gjyqësore *Shala* u kërkoi palëve dhe pjesëmarrësve të dorëzonin parashtrime lidhur me miratimin e një kornize për trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe të dëshmitarëve duke marrë si pikënisje këtë Kornizë, mirëpo nuk u arrit dot një propozim i përbashkët. Shih KSC-BC-2020-04, F00289, Vendim për Caktimin e Datave të Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për Parashtrime nga Palët, 30 shtator 2022, para. 9(A)(f); KSC-BC-2020-04, Urdhër drejtuar Palëve dhe Pjesëmarrësve për të Dorëzuar Kërkesë të Përbashkët lidhur me Kornizën për Trajtimin e Informacionit Konfidencial brenda 16 nëntorit 2022, Transkripti, 19 tetor 2022, f. 405-406; KSC-BC-2020-04, F00353, Parashtrim i Përbashkët lidhur me Miratimin e një Kornize për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar, 16 nëntor 2022.

<sup>81</sup> Pjesa e Kornizës që bën fjalë për kontaktin midis një pale ose pjesëmarrësi me dëshmitarët e palës ose pjesëmarrësit kundërshtar është në thelb e njëjtë me Protokollin e Çështjes 07, me përjashtim të rolit të Zyrës Administrative për përgatitjen dhe kryerjen e intervistave. Shih Protokollin e Çështjes 07, para. 27-40.

<sup>82</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 131.

<sup>83</sup> Shih më lart, para. 27. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 117.



mbrojtjes së dëshmitarëve, privatësisë dhe ruajtjes së provave, por konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e shpërdoroi diskrecionin e tij kur konstatoi se miratimi i Kornizës ishte i nevojshëm në rrethanat kësaj çështjeje gjyqësore.<sup>84</sup>

32. Duke qenë se Korniza nuk përbën masa mbrojtëse shtesë sipas rregullës 80 të Rregullores, fakti që Korniza nuk është parashikuar si masë në rregullën 80, nuk është relevante. Sipas mendimit të Panelit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ishte i detyruar të jepte arsye që veprimi jashtë kuadrit të rregullës 80.<sup>85</sup> Për të njëjtat arsye, Paneli nuk bindet nga argumenti i Mbrojtjes që, sipas nenit 39(1) dhe (11) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhej të kryente vlerësimin nëse ishin të disponueshme masa më pak kufizuese.<sup>86</sup> Standardi ligjor i propozuar nga Krasniqi është i dallueshëm sepse ka të bëjë me masat mbrojtëse dhe zbatohet vetëm në kontekstin kur informacioni nuk i jepet palës marrëse, në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit dhe rregullat 80(1) dhe 108(1) të Rregullores, që nuk është rasti i kësaj Kornize.<sup>87</sup> Paneli vëren gjithashtu se jurisprudenca ku mbështetet Krasniqi është e pavend, sepse asnjë prej vendimeve të cituara nuk ka të bëjë me vendosjen e protokolleve për kontaktet me dëshmitarët.<sup>88</sup> Krahas kësaj, dhe megjithëse Krasniqi pretendon se

<sup>84</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 117.

<sup>85</sup> *Contra* Apeli i Veselit, para. 16.

<sup>86</sup> *Contra* Apeli i Krasniqit, para. 20, 31-34.

<sup>87</sup> Shih Kornizën mbi Nxjerrjet, para. 85; Korniza mbi Kërkesat e Viktimave, para. 47. Shih edhe, p.sh., F00133/COR/CONF/RED, Version i redaktuar konfidencial i versionit të korigjuar të Vendimit të parë në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për masa mbrojtëse, 14 dhjetor 2020 (konfidencial) (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 10 dhjetor 2020, versioni i korigjuar rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 14 dhjetor 2020), para. 20. Shih edhe, p.sh., IRMCT, *Prosecutor v. Kamuhanda*, MICT-13-33, Decision on an appeal of a decision rendered by a Single Judge, 6 October 2017, para. 14 (ku Dhoma e Apelit e MPNTP-së konstatoi se mjetet e përdorura për të siguruar pëlqimin e një dëshmitari të mbrojtur për të dhënë intervistë nuk devijojnë nga parimi sipas të cilit masat mbrojtëse duhet të jenë sa më pak kufizuese).

<sup>88</sup> Shih ICC, *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-475, Judgment on the appeal of the Prosecutor against the decision of Pre-Trial Chamber I entitled "First Decision on the Prosecution Request for Authorisation to Redact Witness Statements", 13 May 2008, para. 59, 67, cituar në Apelin e Krasniqit, poshtëshënimet 29, 59 (lidhur me kërkesat për redaktime si masa mbrojtëse sipas rregullës 81(4) të Rregullores së procedurës dhe Provave të GJPN-së); ECtHR, *Dayanan v. Turkey*, no. 7377/03, Judgment, 13 October 2009 ("*Dayanan v. Turkey*"), para. 32, cituar në Apelin e Krasniqit, poshtëshënimi 28 (lidhur me të drejtën për avokat mbrojtës); ECtHR, *Paci v. Belgium*, no. 45597/09, Judgment, 17 April 2018, para. 85, cituar në Apelin e Krasniqit, poshtëshënimi 28 (lidhur me materialin që nuk i nxirret të akuzuarit); ECtHR, *B and P v. The United Kingdom*, nos 36337/97 and 35974/97, Judgment, 24 April 2001, para. 37,



Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori parasysh mundësi më pak ndërhyrëse që ishin të disponueshme,<sup>89</sup> Paneli vëren se ai e paraqet këtë argument për herë të parë në apel dhe nuk i përmendi këto masa konkrete në parashtrimet e tij para Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Sidoqoftë, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri vlerësim nëse Korniza respekton të drejtat e të akuzuarve dhe nëse kishte drejtpeshim midis funksioneve që propozon Korniza dhe ndikimit të të drejtat për gjykim të drejtë.<sup>90</sup> Gabimet e pretenduara lidhur me këtë vlerësim trajtohen me hollësi më poshtë.<sup>91</sup>

33. Gjithashtu, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes, Paneli konstaton se fakti që Mbrojtja dhe ZPS-ja kanë detyrimin të zbatojnë Kodin e Etikës nuk e bën Kornizën të panevojshme. Megjithëse Kodi i Etikës parashikon se mbrojtësit duhet t'i kryejnë detyrat me ndershmëri dhe parashikon një sërë detyrimesh për palët dhe pjesëmarrësit,<sup>92</sup> ka disa tema të cilat ai nuk i mbulon, siç janë kontaktet me palët dhe pjesëmarrësit jothirrës, të cilat gjithsesi trajtohen në Kornizë. Për këtë arsye, Korniza nuk është e tepërt dhe ishte i arsyeshëm konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se nevojiteshin masa të mëtejshme mbrojtëse për dëshmitarët përtej detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Etikës, për arsyet e paraqitura prej tij.<sup>93</sup>

---

cituar në Apelin e Krasniqit, poshtëshënimi 31 (lidhur me kufizimet mbi natyrën publike të procedurave); TPNJ, *Prokurori kundër Millosheviqit*, IT-02-54-AR73.7, Vendim mbi Apelin e Ndërmjetëm të Vendimit të Trupit Gjykoës për Caktimin e Mbrojtësit, 1 nëntor 2004, para. 17, cituar në Apelin e Krasniqit, poshtëshënimi 27 (lidhur me kufizimet mbi të drejtën e vetëpërfaqësimit); TPNJ, *Prokurori kundër Limajt dhe të tjerëve*, IT-03-66-AR65, Vendim mbi Kërkesën e Fatmir Limajt për Lirim të Përkohshëm, 31 tetor 2003, para. 13, cituar në Apelin e Krasniqit, poshtëshënimi 27 (lidhur me lirimin e përkohshëm).

<sup>89</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 5, poshtëshënimi 8 (ku Krasniqi përmend që incizimi i intervistave për qëllim parandalues t'i nxirret Trupit Gjykoës vetëm nëse del ndonjë problem lidhur me zhvillimin e intervistës, dhe duke i dhënë rol Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve – jo ZPS-së – në kontaktimin e dëshmitarëve). Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 31-32.

<sup>90</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 137-177.

<sup>91</sup> Shih më poshtë, Pjesa IV.C.

<sup>92</sup> Shih, p.sh., Kodi i Etikës, nenet 6, 12, 17. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 170.

<sup>93</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 130.

34. Së fundi, Paneli mendon se pyetja nëse ka pasur në fakt ndonjë problem ndërhyrjeje apo frikësimi të dëshmitarëve në këtë çështje gjyqësore nuk ka lidhje me pyetjen nëse Korniza mund të konsiderohet e nevojshme, sepse ajo synon të jetë instrument parandalues.<sup>94</sup> Në lidhje me këtë, Paneli gjithashtu nuk konstaton asnjë gabim në faktin se, ndonëse e mbajti parasysh argumentin e Mbrojtjes se ajo nuk është akuzuar për ndonjë shkelje në këtë fushë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mori në konsideratë atmosferën e përgjithshme të frikësimit si arsye shtesë për miratimin e Kornizës, krahas nevojës për të siguruar mbrojtjen dhe privatësinë e dëshmitarëve dhe ruajtjen e provave.<sup>95</sup>

35. Mbështetur në sa më lart, Paneli konstaton se Mbrojtja nuk ka demonstruar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake shpërdoroi diskrecionin e tij me miratimin e Kornizës mbi bazën e neneve 35(2)(f) dhe 39(1) dhe (11) të Ligjit. Rrjedhimisht, rrëzohen Pika B e Apelit të Thaçit pjesërisht, Pika 1 e Apelit të Krasniqit dhe Pikat A dhe B të Apelit të Veselit.

B. NËSE KORNIZA DUHEJ TË BËNTE DALLIM MES DËSHMITARËVE (PIKA B E APELIT TË THAÇIT, PJESËRISHT; PIKA 1 E APELIT TË SELIMIT; PIKA 2 E APELIT TË KRASNIQIT)

36. Paneli i Gjykatës së Apelit gjykon se një pjesë e Pikës B të Apelit të Thaçit (që përkon me pikën e katërt të Thaçit), Pika 1 e Apelit të Selimit (që përkon me pikën e parë të Selimit), si edhe Pika 2 e Apelit të Krasniqit (që përkon me pikën e tretë të Krasniqit), kanë ngjashmëri të konsiderueshme, sepse që të gjitha ngrenë argumente që kanë të bëjnë me pyetjen nëse Korniza duhet zbatuar për të gjithë dëshmitarët, pa bërë dallim mes dëshmitarëve sa i takon mbrojtjes së nevojshme. Rrjedhimisht, këto pika apeli do të shqyrtohen bashkërisht.

---

<sup>94</sup> *Contra* Apeli i Thaçit, para. 45; Apeli i Krasniqit, para. 22-23.

<sup>95</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 118, 170. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 211.

## 1. Parashtrimet e palëve

37. Thaçi, Selimi dhe Krasniqi parashtrojnë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që e zbatoi Kornizën pa dallim për të gjithë dëshmitarët e ZPS-së, pavarësisht nëse kanë nevojë për mbrojtje ose jo.<sup>96</sup> Thaçi dhe Krasniqi theksojnë se, duke pasur parasysh larminë e dëshmitarëve të ZPS-së, me nevoja shumë të ndryshme sa u takon masave mbrojtëse, trajtimi i tyre të gjithë njësoj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishte i gabuar.<sup>97</sup> Në veçanti, ata argumentojnë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bëri vlerësim më vete për çdo dëshmitar nëse zbatimi i Kornizës ishte *i nevojshëm*.<sup>98</sup> Në mënyrë të ngjashme, Selimi parashtron se Korniza duhet të përfshinte kriterin që dëshmitarët të vërtetonin lidhjen midis rrezikut të identifikuar dhe rrethanave të veçanta të tyre.<sup>99</sup> Sipas tij, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e bëri këtë lidhje “në kontrast të plotë me dëshmitarët e rregullës 80” për të cilët duhet kryer një vlerësim i individualizuar i nevojës për masa mbrojtëse.<sup>100</sup> Krasniqi argumenton gjithashtu se nuk do të ishte “tejet e vështirë” që në zbatimin e Kornizës të ndiqej e njëjta qasje si për masat mbrojtëse të miratuara në mënyrë individuale dhe parashtror se nuk do të kishte kundërshtim që të konsiderohet se Korniza zbatohet për dëshmitarët për të cilët është miratuar shtyrja e nxjerrjes së informacionit si grup.<sup>101</sup>

38. Thaçi, Selimi dhe Krasniqi kundërshtojnë vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që Korniza të zbatohet për të gjithë dëshmitarët ndërkombëtarë ose të

---

<sup>96</sup> Apeli i Thaçit, para. 38, 40-41, 44; Apeli i Selimit, para. 9-10, 21, 26; Apeli i Krasniqit, para. 35, 38, 44. Shih edhe Apelin e Thaçit, para. 1, 7; Apeli i Krasniqit, para. 3; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 2. Veseli kundërshton gjithashtu natyrën jo të individualizuar të Kornizës, e cila zbatohet automatikisht për të gjithë dëshmitarët e ZPS-së pavarësisht nga rrethanat e veçanta të tyre. Shih Apelin e Veselit, para. 14, 17, 22.

<sup>97</sup> Apeli i Thaçit, para. 38, 40-41; Apeli i Krasniqit, para. 36-38. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 2.

<sup>98</sup> Apeli i Krasniqit, para. 38; Apeli i Thaçit, para. 40-41.

<sup>99</sup> Apeli i Selimit, para. 3, 9-10, 24. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 17, 19, 22, 26.

<sup>100</sup> Apeli i Selimit, para. 10, 22-24. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 17; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 11.

<sup>101</sup> Apeli i Krasniqit, para. 39. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 36; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 11.

rangut të lartë.<sup>102</sup> Ata parashtrojnë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk dha arsye dhe shpërdoroi diskrecionin e tij sepse nuk kishte asnjë bazë faktike për konstatimin e tij,<sup>103</sup> duke argumentuar në veçanti se: (i) kjo ia kalon mbrojtjes detyrimit e vërtetimit se Korniza duhet t'i përjashtojë këta dëshmitarë, në vend që t'i kërkohej ZPS-së të vërtetojë se Korniza duhet zbatuar për ta;<sup>104</sup> (ii) e gjithë kategoria e dëshmitarëve ndërkombëtarë ndodhet jashtë zonës gjeografike ku ekziston atmosfera e pretenduar e ndërhyrjes tek dëshmitarët, që përfshin vetëm Kosovën;<sup>105</sup> (iii) asnjë dëshmitar në atë kategori nuk ka kërkuar mbrojtje dhe as nuk është ankuar për ndërhyrje, megjithëse Mbrojtja ua di identitetin;<sup>106</sup> dhe (iv) postet që kishin dëshmitarët në 1998-1999 nuk janë relevante, sepse ajo që duhet të ketë rëndësi janë postet, rrethanat dhe cenueshmëria e tyre e tanishme.<sup>107</sup>

39. Në fund, Selimi argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që u mbështet në Protokollin e GJPN-së si udhëzues në interpretimin e kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara dhe ndërkohë shpërfilli vendimet e Gjykatës Penale Ndërkombëtare ("GJPN") në të cilat shihet një zbatim shumë më i ngushtë i kompetencave të gjykatësve për mbrojtje sipas nenit 57(3)(c) të Statutit të Romës në raste individuale, duke treguar kështu njëfarë mospërputhjeje në jurisprudencë.<sup>108</sup> Selimi parashtron se në këto raste, dhomat gjyqësore të GJPN-së në fakt zbatuan një

<sup>102</sup> Apeli i Thaçit, para. 42; Apeli i Selimit, para. 10-12, 23-24; Apeli i Krasniqit, para. 40-43, ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 120. Shih edhe Apelin e Thaçit, para. 1, 38; Apeli i Krasniqit, para. 36-37; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 11; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 13.

<sup>103</sup> Shih Apelin e Thaçit, para. 42; Apeli i Selimit, para. 10, 24-25; Apeli i Krasniqit, para. 41-42.

<sup>104</sup> Apeli i Krasniqit, para. 40. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 26.

<sup>105</sup> Apeli i Krasniqit, para. 41. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 37.

<sup>106</sup> Apeli i Krasniqit, para. 41. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 23; Apeli i Krasniqit, para. 37, 42.

<sup>107</sup> Apeli i Krasniqit, para. 43. Shih edhe Apelin e Thaçit, para. 42.

<sup>108</sup> Apeli i Selimit, para. 3, 13-18, 20, ku i referohet ndër të tjera ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-428-Corr, Corrigendum to the Decision on the Evidentiary Scope of the Confirmation Hearing, Preventive Relocation and Disclosure under Article 67(2) of the Statute and Rule 77 of the Rules, 25 April 2008 ("*Katanga and Ngudjolo Chui* Decision"), para. 41-[52]; ICC, *Prosecutor v. Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-51, Decision on Defence Request for an Order to Preserve the Impartiality of the Proceedings, 31 January 2011 ("*Mbarushimana* Decision"), para. 2-3, 6-17; ICC, *Prosecutor v. Gaddafi and Al-Senussi*, ICC-01/11-01/11-129, Decision on OPCD Requests, 27 April 2012 ("*Gaddafi* Decision"), para. 1-9, 11, 13-14. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 7-10.

qasje të njëtrajtohme që kërkon një “metodë vlerësimi mbështetur në një standard që kërkon vërtetimin e lidhjes midis rrezikut dhe dëshmitarit”.<sup>109</sup>

40. Mbrojtësi i Viktimave dhe ZPS-ja përgjigjen se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gaboi që e zbatoi Kornizën për të gjithë dëshmitarët.<sup>110</sup> Ata theksojnë se Korniza nuk kërkon kryerjen e vlerësimit individual të rrezikut sipas rregullës 80 të Rregullores, sepse ajo nuk ofron masa mbrojtëse shtesë dhe nuk kërkon që Mbrojtjes të mos i jepet informacion.<sup>111</sup> ZPS-ja parashtron se Mbrojtja i ngatërron masat e rregullës 80 me masat e Kornizës dhe se nuk ka asnjë kundërshti midis dy vlerësimeve të ndryshme.<sup>112</sup> Sipas mendimit të Mbrojtësit të Viktimave, ka “së paku njëfarë pranimi” nga ana e Mbrojtjes se Korniza mund të jetë e nevojshme për dëshmitarët me status të dyfishtë.<sup>113</sup> Mbrojtësi i Viktimave parashtron gjithashtu se rregullimi i komunikimit midis dëshmitarëve dhe palës kundërshtare që bëhet në Kornizë është i përligjur për të trajtuar atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes ndaj tyre.<sup>114</sup> Mbrojtësi i Viktimave dhe ZPS-ja nënvizojnë gjithashtu se Korniza nuk do të zbatohet medoemos në tërësi për të gjithë dëshmitarët dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka lejuar njëfarë “përshtatjeje”.<sup>115</sup> Së fundi, Mbrojtësi i Viktimave dhe ZPS-ja argumentojnë se jurisprudenca e GJPN-së së cilës i referohet Selimi nuk është

---

<sup>109</sup> Apeli i Selimit, para. 17, 20. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 18-19.

<sup>110</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 5, 49-63; Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 47-48, 54-56.

<sup>111</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 60; Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 55.

<sup>112</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 54.

<sup>113</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 50. Shih edhe Përgjigjen e Mbrojtësit të Viktimave, para. 5, 51.

<sup>114</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 58-61. Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 42.

<sup>115</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 62; Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 56.

relevante.<sup>116</sup> ZPS-ja parashtron se Protokoli i GJPN-së është zbatuar në një sërë vendimesh të GJPN-së të cilat, sipas saj, janë “më relevante”.<sup>117</sup>

41. Selimi kundërpërgjigjet se “fokusimi i veçantë” i Gjykatësit të Procedurës Paraprake në fjalët “kur është e nevojshme” dëshmon relevancën e praktikës gjyqësore në GJPN, sidomos në rast të vendimeve mospërputhëse, dhe argumenton se parashtrimet e ZPS-së “shtrembërojnë” vendimet e GJPN-së të cilave ai u referohet.<sup>118</sup> Ai parashtron gjithashtu se as ZPS-ja, as Mbrojtësi i Viktimave, nuk bëjnë parashtrime për arsyetimin mospërputhës të Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me domosdoshmërinë e zbatimit të Kornizës për të gjithë dëshmitarët.<sup>119</sup>

42. Në kundërpërgjigje, Krasniqi shpreh kundërshtim ndaj mbështetjes së ZPS-së në prova “të vjetruara” për atmosferën e pretenduar të frikësimit për të përligjur Kornizën dhe pretendon se këto konstatime janë përsëritëse dhe nuk mbështeten në prova të reja.<sup>120</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

43. Paneli rikujton konstatimin e tij se nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kërkohet ta kushtëzonte zbatimin e Kornizës me ekzistencën e rrezikut dhe të kryente vlerësim individual të situatës për çdo dëshmitar, sepse Korniza nuk u krijua në bazë të rregullës 80 të Rregullores dhe ajo nuk përbën masa mbrojtëse.<sup>121</sup> Ky vlerësim i rrezikut kërkohet vetëm në kuadër të masave mbrojtëse sipas rregullës 80, sepse ato kanë të bëjnë me mosnxjerrjen e të dhënave të dëshmitarëve për Mbrojtjen, që nuk

<sup>116</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 63; Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 49-53. ZPS-ja parashtron gjithashtu se Selimi nuk u është referuar këtyre vendimeve në parashtrimet e tij para Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 49.

<sup>117</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 22, 53 dhe referencat e cituara aty. Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 20-21, 23.

<sup>118</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 5-10.

<sup>119</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 11.

<sup>120</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 14-15. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 16; Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 9.

<sup>121</sup> Shih më lart, para. 31-32.



është rasti i asnjë prej masave të parashikuara në Kornizë. Rrjedhimisht, Paneli i rrezon argumentet e Mbrojtjes lidhur me nevojën për të kryer vlerësim individual të rreziqeve të hasura personalisht nga secili dëshmitar dhe të ekzistencës së lidhjes me një rrezik faktik.<sup>122</sup> Sipas mendimit të Panelit, rrjedhimisht nuk është relevante nëse masat që rregullojnë kontaktet midis dëshmitarëve dhe palës jothirrëse u trajtuan si masa mbrojtëse nga disa dhoma të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (“TPNR”) dhe Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”).<sup>123</sup>

44. Për pasojë, dhe duke qenë se Korniza nuk përbën masa mbrojtëse, Paneli nuk sheh asnjë gabim në konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se “nuk kishte asnjë bazë” që Korniza të zbatohet vetëm për dëshmitarët që kanë nevojë për mbrojtje dhe për të cilët janë miratuar masa sipas rregullës 80 të Rregullores.<sup>124</sup> Paneli gjykon gjithashtu se Vendimi i Kundërshtuar nuk mund të interpretohet se konstaton që të gjithë dëshmitarët kanë të njëjtat shqetësime për sigurinë apo se “vendos shenjë e barazimit” midis rrethanave të të gjithë dëshmitarëve.<sup>125</sup> Fakti se dëshmitarët mund të kenë nevoja të ndryshme sa u takon masave mbrojtëse nuk është pengesë që Korniza të zbatohet për të gjithë dëshmitarët. Nuk ka asnjë kundërshti midis sistemit të masave mbrojtëse dhe sistemit të Kornizës, duke qenë se ata janë dy procese më vete që ndjekin objektiva të ndryshme dhe bashkekzistojnë pa përsëritur njëri-tjetrin.

<sup>122</sup> Shih më lart, para. 32. *Contra* Apeli i Thaçit, para. 41; Apeli i Selimit, para. 10, 21-24; Apeli i Krasniqit, para. 38-39, poshtëshënime 58-60.

<sup>123</sup> Shih Apelin e Krasniqit, poshtëshënimi 58, ku i referohet ICTR, *Prosecutor v. Nindiliyimana et al.*, ICTR-00-56-T, Decision on Bizimungu’s Extremely Urgent Motion to Contact and Meet with Prosecution Witness GAP, 26 October 2007 (“*Nindiliyimana et al.* Decision”); ICTR, *Prosecutor v. Niyitegeka*, ICTR-96-14-T, Decision (Prosecutor’s Request to Contact Defence Witnesses and Their Family Members), 10 October 2002 (“*Niyitegeka* Decision”). Shih edhe, p.sh., ICTY, *Prosecutor v. Blagojević et al.*, IT-02-60-PT, Order for Protective Measures and Non-Disclosure to the Public, 18 February 2003; ICTR, *Prosecutor v. Ngirabatware*, ICTR-99-54-T, Decision on Defence urgent Motion for Witness Protective Measures, 9 February 2010 (“*Ngirabatware* Decision”).

<sup>124</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 136. Paneli vëren se edhe Protokoli i Çështjes 07 dhe Protokoli i GJPN-së zbatohen për të gjithë dëshmitarët dhe jo vetëm për dëshmitarët e mbrojtur. Shih Protokollin e Çështjes 07, para. 27; Protokoli i GJPN-së, para. 28.

<sup>125</sup> *Contra* Apeli i Thaçit, para. 38, 41. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 23; Apeli i Krasniqit, para. 36.

45. Paneli gjithashtu nuk konstaton gabim në faktin se Korniza zbatohet edhe për dëshmitarët e rangut të lartë dhe/ose ndërkombëtarë.<sup>126</sup> Paneli nuk është bindur nga argumentet e Mbrojtjes sipas të cilave kjo kategori dëshmitarësh nuk duhet të përfshihet në Kornizë, përveç nëse janë objekt i masave mbrojtëse sipas rregullës 80 dhe/ose kanë shprehur frikë. Duke pasur parasysh se zbatimi i Kornizës nuk kushtëzohet nga ekzistenca e nevojës faktike për mbrojtje dhe se Korniza ka natyrë parandaluese, ajo zbatohet për të gjithë dëshmitarët e njoftuar, pavarësisht nëse kanë shprehur ose jo shqetësime për sigurinë. Rrjedhimisht, nuk ka rëndësi nëse dëshmitarët e rangut të lartë dhe/ose ndërkombëtarë janë ankuar për ndonjë parregullsi, ose nëse ata gjenden jashtë kuadrit gjeografik të ndërhyrjeve ndaj dëshmitarëve.<sup>127</sup> Për këto arsye, Paneli konstaton se nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kërkohej të bënte dallimin midis kategorive të dëshmitarëve dhe as të jepte arsye përse Korniza zbatohet edhe për kategori të caktuara dëshmitarësh.<sup>128</sup>

46. Pavarësisht nga kjo, Paneli nuk sheh asnjë gabim që, gjithsesi, gjatë marrjes së vendimit për miratimin e Kornizës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mori parasysh ndër të tjera atmosferën e frikësimit dhe të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe faktin që një numër i konsiderueshëm dëshmitarësh në këtë çështje gjyqësore përfitojnë masa mbrojtëse<sup>129</sup>, si edhe faktin që ajo ka një numër objektivash që shkojnë përtej mbrojtjes së dëshmitarëve.<sup>130</sup>

47. Sa u takon vendimeve të GJPN-së të cilave u referohet Selimi,<sup>131</sup> Paneli vëren se, ndonëse Selimi pretendon se “bie në sy shpërfillja” e tyre nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,<sup>132</sup> në fakt, ato për herë të parë përmenden në apel. Kjo, në vetvete, do të përligjte rrëzimin e menjëhershëm të parashtrimeve të Selimit për këtë

---

<sup>126</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 120. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 187.

<sup>127</sup> Shih më lart, para. 34. *Contra* Apeli i Krasniqit, para. 40-43.

<sup>128</sup> *Contra* Apeli i Thaçit, para. 42, 44.

<sup>129</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 118. Shih edhe më lart, para. 34.

<sup>130</sup> Shih më lart, para. 26-27.

<sup>131</sup> Shih Apelin e Selimit, para. 14-16 dhe jurisprudenca e cituar aty.

<sup>132</sup> Shih Apelin e Selimit, para. 13, 19-20.

aspekt.<sup>133</sup> Sidoqoftë, Paneli vëren se asnjë prej vendimeve të cituara nuk ka të bëjë me vendosjen e protokolleve për kontaktet me dëshmitarët dhe/ose ato nuk dëshmojnë se protokolle të tilla u zbatuan vetëm pas konstatimit të rreziqeve faktike me të cilat përballen dëshmitarët.<sup>134</sup> Fakti se disa dhoma të GJPN-së ushtruan diskrecionin e tyre dhe morën parasysh ekzistencën e rrezikut gjatë vlerësimit nëse duhet të urdhëronin masa të individualizuara për dëshmitarët në bazë të nenit 57(3)(c) të Statutit të Romës, nuk përjashton mundësinë e miratimit, sipas së njëjtës bazë ligjore, të masave më të gjera që nuk kushtëzohen me ekzistencën e rrezikut të vërtetuar, siç e tregon fakti se dhoma të shumta kanë miratuar, mbështetur në Protokollin e GJPN-së, protokolle për kontaktet me dëshmitarët të zbatueshme për të gjithë dëshmitarët.<sup>135</sup> Madje, vendimet e përmendura nga Selimi në fakt konfirmojnë kompetencat dhe diskrecionin e gjerë të gjykatësve për të miratuar një varg masash sipas kësaj dispozite.

48. Së fundi, Paneli vëren se, ndonëse supozohet se synohet që ajo të zbatohet për të gjithë dëshmitarët e njoftuar, Korniza lejon njëfarë përshtatjeje në varësi të rrethanave dhe disa prej elementeve të saj zbatohen vetëm me kërkesë të

<sup>133</sup> Shih, p.sh., Vendimin mbi Apelin e Haradinajt, para. 29.

<sup>134</sup> Shih *Katanga and Ngudjolo Chui* Decision (që ka të bëjë me përfshirjen e një dëshmitari të caktuar në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve të GJPN-së); *Mbarushimana* Decision (që ka të bëjë me atë nëse duheshin marrë masa për ruajtjen e prezumimit të pafajësisë të të akuzuarit); *Gaddafi* Decision (që ka të bëjë me lëshimin e urdhrave të bashkëpunimit për ta ndihmuar të akuzuarin të përgatisë mbrojtjen, ndërkohë që masa të tilla ishin urdhëruar edhe në bazë të nenit 57(3)(b) të Statutit të Romës).

<sup>135</sup> Shih, p.sh., ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1372, Decision on the prosecution's application for an order governing disclosure of non-public information to members of the public and an order regulating contact with witnesses., 4 June 2008 ("*Lubanga* Order Regulating Contacts with Witnesses"), para. 5, 11, 14; ICC, *Prosecutor v. Yekatom and Ngaissona*, ICC-01/14-01/18-156-AnxA, Annex A to the Decision on a Protocol on the Handling of Confidential Information and Contacts with Witnesses, 22 March 2019; ICC, *Prosecutor v. Ali Kushayb*, ICC-02/05-01/20-691-Anx, Annex to the Decision adopting an updated protocol on the handling of confidential information and contact with witnesses, 18 May 2022; ICC, *Prosecutor v. Ruto and Sang*, ICC-01/09-01/11-449-Anx, Annex to Decision on the protocol concerning the handling of confidential information and contacts of a party with witnesses whom the opposing party intends to call, 24 August 2012; ICC, *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-674-Anx2, Annex 2 to the Decision on the 'Protocol on the handling of confidential information during investigations and contact between a party or participant and witnesses of the opposing party or of a participant', the 'Dual Status Witness Protocol', and related matters, 19 March 2020; ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-2293, Decision on the "Prosecution Motion on Procedure for Contacting Defence Witnesses and to Compel Disclosure", 4 September 2012.

dëshmitarit.<sup>136</sup> Sidoqoftë, palët rezervojnë të drejtën e përgjithshme të kërkojnë mjete juridike të përshtatshme, kur është e nevojshme, në lidhje me problemet që lindin nga zbatimi i Kornizës.<sup>137</sup> Paneli vëren më tej se palët tashmë kanë mundur të arrijnë marrëveshje për të devijuar nga disa pjesë të caktuara të Kornizës kur e lejojnë rrethanat.<sup>138</sup>

49. Mbështetur në sa më lart, rrëzohen një pjesë e Pikës B të Apelit të Thaçit, Pika 1 e Selimit dhe Pika 2 e Krasniqit.

### C. NËSE KORNIZA SHKEL TË DREJTAT E TË AKUZUARVE

#### 1. Nëse Korniza shkel të drejtën e të akuzuarve për mosinkriminimin e vetes (Pika 3 e Apelit të Krasniqit, pjesërisht)

##### (a) Parashtrimet e palëve

50. Në Pikën 3 (që përkon me pikën e gjashtë të Krasniqit), Krasniqi parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se Korniza nuk shkel të drejtën e të akuzuarve për mosinkriminimin e vetes.<sup>139</sup> Sipas mendimit të tij, Vendimi i Kundërshtuar shpërfill mënyrat e tërthorta me të cilat Korniza shkel të drejtën e mosinkriminimit të vetes, duke qenë se prania e ZPS-së gjatë intervistave dhe nxjerrja e detyrueshme të intervistave të incizuara për ZPS-në e detyron Mbrojtjen të zgjedhë – ose të hulumtojë linja pyetjesh duke rrezikuar që t'i jepet ZPS-së material që mund të jetë vetinkriminues, ose të mos e bëjë këtë, duke humbur kështu informacion që mund të jetë i vlefshëm për mbrojtjen.<sup>140</sup> Krasniqi parashtron se në këtë situatë

<sup>136</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 119. Në veçanti, disa masa mbrojtëse të parashikuara nga Korniza – siç është prania e përfaqësuesit të palës thirrëse – do të vihen në lëvizje vetëm nëse kërkohen nga dëshmitari ose në varësi të shqyrtimit gjyqësor. Shih, p.sh., Kornizën, para. 212(II)(b).

<sup>137</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 151, 175. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 143, 159.

<sup>138</sup> Shih, p.sh., F00963, Njoftim në lidhje me Vendimin F00854, 12 shtator 2022 (konfidencial).

<sup>139</sup> Apeli i Krasniqit, para. 45-46, ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 150. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 4.

<sup>140</sup> Apeli i Krasniqit, para. 46. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 47; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 19-21. Në mënyrë të ngjashme, Thaçi argumenton se një situatë e tillë e detyron Mbrojtjen të kryejë intervista më të kufizuara për të shmangur daljen e informacioneve inkriminuese, ose që të heqë dorë nga intervista. Shih Apelin e Thaçit, para. 35.

Mbrojtja nuk është “e lirë” të përcaktojë strategjitë për paraqitjen e provave të saj.<sup>141</sup> Ai shton se, fakti që pranueshmëria e intervistës varet nga autorizimi gjyqësor nuk e zgjidh problemin që ZPS-ja gjithsesi do të mësonte informacione vetinkriminuese të cilat më pas mund t’i hetojë apo t’i paraqesë si prova me mënyra të tjera.<sup>142</sup> Krasniqi thekson gjithashtu rastet kur dëshmitarët nuk dëshirojnë të flasin me ZPS-në për shkak të rrezikut të vetinkriminimit dhe argumenton se vendimi i tyre për të folur me Mbrojtjen “cenohet njësoj” nga këto masa.<sup>143</sup>

51. ZPS-ja përgjigjet se Korniza nuk shkel të drejtën e mosinkriminimit të vetes dhe thekson garancitë mbrojtëse e përmendura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake; veçanërisht faktin se prania e ZPS-së në intervista dhe pranimi i incizimeve në prova varet nga autorizimi gjyqësor.<sup>144</sup> Sipas ZPS-së, e drejta për të mos inkriminuar veten nuk përfshin edhe përdorimin e deklaratave të dëshmitarëve të marra nga Mbrojtja.<sup>145</sup> ZPS-ja argumenton gjithashtu se Krasniqi nuk jep asnjë mbështetje nga jurisprudenca për pretendimet e tij për shkelje “të tërthortë” dhe parashtron se nuk janë të pranishme asnjë prej llojeve të detyrimit të palejueshëm të identifikuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”).<sup>146</sup> Sipas mendimit të ZPS-së, zgjedhja për ta formuluar pyetjen në mënyrë që zbulon apo nuk zbulon prova inkriminuese nuk përbën shkelje të së drejtës për mosinkriminimin e vetes.<sup>147</sup> Në fund, ZPS-ja argumenton se Krasniqi nuk ka të drejtë të ngrejë pretendime në emër të dëshmitarëve

---

<sup>141</sup> Apeli i Krasniqit, para. 46; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 21.

<sup>142</sup> Apeli i Krasniqit, para. 47, ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 151-152. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 20.

<sup>143</sup> Apeli i Krasniqit, para. 49. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 37(2); Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 20.

<sup>144</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 62-63. Shih edhe Përgjigjen e Mbrojtësit të Viktimave, para. 33.

<sup>145</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 62.

<sup>146</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 65 dhe jurisprudenca e cituar aty. ZPS-ja shton se Krasniqi citon një çështje të vetme, e cila nuk mbështet konstatimin për shkelje të së drejtës së mosinkriminimit të vetes. Shih Apelin e Krasniqit, para. 46.

<sup>147</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 66-67. ZPS-ja parashtron gjithashtu se parashtrimet e Krasniqit janë hamendësuese. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 67.

dhe nuk shpjegon përse ai do të kishte të drejtën të merrte deklarata vetinkriminuese nga dëshmitarët.<sup>148</sup>

52. Në të njëjtën mënyrë, Mbrojtësi i Viktimave përgjigjet se zgjedhja se çfarë do të thuhet, nëse do të thuhet diçka, gjatë intervistës së dëshmitarit, i takon Mbrojtjes dhe nuk rregullohet nga Korniza.<sup>149</sup> Mbrojtësi i Viktimave parashton gjithashtu se Krasniqi nuk jep asnjë bazë për pretendimin e tij për shkelje të tërthortë të së drejtës për mosinkriminimin e vetes.<sup>150</sup>

53. Krasniqi kundërpërgjigjet se interpretimi që i bën ZPS-ja të drejtës për mosinkriminimin e vetes është tejet kufizues, sepse ajo nuk kufizohet vetëm në të drejtën për të heshtur dhe nuk duhet të cenohet nga detyrimet që i vendosen Mbrojtjes.<sup>151</sup> Ai parashton gjithashtu se ZPS-ja shpërfill natyrën “asimetrike” të sistemit të nxjerrjes së materialeve në Dhomat e Specializuara, sepse nuk ekziston asnjë detyrim – i barasvlershëm me rregullën 103 të Rregullores – që Mbrojtja t’i nxjerrë ZPS-së informacion inkriminues.<sup>152</sup>

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

54. Fillimisht, Paneli i Gjykatës së Apelit rikujton se neni 21(4)(h) i Ligjit dhe neni 30(6) i Kushtetutës së Kosovës u garantojnë të akuzuarve të drejtën të mos detyrohen të dëshmojnë kundër vetes apo të pranojnë fajësinë. Krahas kësaj, dhe megjithëse kjo e drejtë nuk përmendet konkretisht në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”), e drejta për të heshtur dhe privilegji i mosinkriminimit të vetes

---

<sup>148</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 68.

<sup>149</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 33.

<sup>150</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 33.

<sup>151</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 18.

<sup>152</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 21. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 19.



janë përgjithësisht standarde ndërkombëtare të pranuar që përbëjnë thelbin e nocionit të procedurës së drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së.<sup>153</sup>

55. Së pari, në lidhje me pretendimin e Krasniqit sipas të cilit Vendimi i Kundërshtuar shpërfill mënyrat e tërthorta me të cilat Korniza shkel privilegjin e mosinkriminimit të vetes,<sup>154</sup> Paneli vëren se nuk kundërshtohet fakti se Korniza nuk përfshin asnjë shkelje të drejtpërdrejtë të atij privilegji. Siç ka vërejtur me të drejtë Gjykatësi i Procedurës Paraprake, dhe siç është vendosur në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e drejta për të mos inkriminuar veten ka të bëjë kryesisht me respektimin e vullnetit të të akuzuarit për të heshtur dhe presupozon që prokuroria në çështje penale duhet të provojë akuzat kundër të dyshuarit pa u bazuar në dëshmi të siguruara përmes metodave të shtrëngimit ose presionit në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit.<sup>155</sup> Gjithashtu, gjatë shqyrtimit nëse një procedurë ka shuar vetë thelbin e privilegjit të mosinkriminimit të vetes, duhen marrë parasysh faktorët e mëposhtëm: lloji dhe shkalla e detyrimit, ekzistenca e garancive mbrojtëse relevante në procedura, si dhe për çfarë përdoren materialet e siguruara në këtë mënyrë.<sup>156</sup> Paneli pajtohet gjithashtu me Mbrojtjen se duhet të vlerësohet drejtësia e procedurave në tërësi, që përfshin edhe mënyrën me të cilën sigurohen provat.<sup>157</sup>

56. Paneli vëren se Mbrojtja nuk citon asnjë jurisprudencë në mbështetje të pretendimit të saj për vetinkriminim të tërthortë, pra që prania e ZPS-së gjatë intervistave dhe/ose fakti që më pas ajo do të marrë transkriptet e detyron të akuzuarin të mos pranojë të hulumtojë linja të marrjes në pyetje të cilat mund të jenë

---

<sup>153</sup> Shih ECtHR, *John Murray v. The United Kingdom*, no. 18731/91, Judgment, 8 February 1996 ("*John Murray v. The United Kingdom*"), para. 45. Shih edhe ECtHR, *Saunders v. The United Kingdom*, no. 19187/91, Judgment, 17 December 1996, para. 68.

<sup>154</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 46.

<sup>155</sup> ECtHR, *Bykov v. Russia*, no. 4378/02, Judgment, 10 March 2009 ("*Bykov v. Russia*"), para. 92. Shih edhe Vendimi i Kundërshtuar, para. 146.

<sup>156</sup> *Bykov v. Russia*, para. 92. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 146.

<sup>157</sup> ECtHR, *Ayetullah Ay v. Turkey*, nos. 29084/07 and 1191/08, Judgment, 27 October 2020, para. 125-126, cituar në Apelin e Krasniqit, poshtëshënimi 66.

të dobishme, për të mbrojtur të drejtën e mosinkriminimit të vetes.<sup>158</sup> Duke mbajtur parasysh se e drejta e mosinkriminimit të vetes nuk përfshin vetëm deklaratat të cilat janë drejtpërdrejt inkriminuese,<sup>159</sup> Paneli vëren se detyrimi i tërthortë ka të bëjë me shumë me përfundimet negative që mund të nxirren nga vendimi i të akuzuarit për të heshtur, si edhe vetëm me situatat që lidhen me sjelljen e vetë të akuzuarit.<sup>160</sup> Gjithashtu, Mbrojtja nuk jep prova në mbështetje të argumentit të saj se privilegji i mosinkriminimit të vetes përfshin edhe deklaratat e siguruara nga Mbrojtja – jo kundër vullnetit të të akuzuarit – që burojnë nga persona të tjerë veç të akuzuarit.

57. Paneli rikujton se privilegji i mosinkriminimit të vetes nuk mbron nga dhënia e deklaratës *per se*, por nga sigurimi i provave nëpërmjet shtrëngimit ose presionit.<sup>161</sup> Sipas mendimit të Panelit, situata e përmendur nga Mbrojtja nuk përbën asnjë prej llojeve të detyrimit të palejueshëm të identifikuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së.<sup>162</sup> Madje Paneli konstaton se fakti që Mbrojtja, përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve, mund të rrezikojë marrjen e ndonjë informacioni inkriminues, nuk përbën vetinkriminim. Mbrojtja nuk vërteton asnjë element detyrimi në këtë proces. Paneli e konstaton gjithashtu jobindës pretendimin e Mbrojtjes se është *e detyruar* të bëjë zgjedhje dhe pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se Mbrojtja do të

<sup>158</sup> Apeli i Krasniqit, para. 46.

<sup>159</sup> ECtHR, *Ibrahim and Others v. The United Kingdom*, nos. 50541/08, 50571/08, 50573/08 and 40351/09, Judgment, 13 September 2016 (“*Ibrahim and Others v. The United Kingdom*”), para. 268.

<sup>160</sup> Shih *John Murray v. The United Kingdom*, para. 50 (ku u konstatua se një sistem që e paralajmëron të akuzuarin se refuzimi për t’i dhënë shpjegim policisë për praninë e tij në vendin e ngjarjes apo për të dëshmuar në gjykim mund të çojë në nxjerrjen e përfundimeve negative për të, marrë së bashku me peshën e provave kundër tij, përbën një nivel të caktuar detyrimi të tërthortë). Krahaso ECtHR, *O’Halloran and Francis v. The United Kingdom*, nos. 15809/02 and 25624/02, Judgment, 29 June 2007, para. 57 (ku gjykata pranoi se në atë rast, detyrimi kishte natyrë të drejtpërdrejtë).

<sup>161</sup> *Ibrahim and Others v. The United Kingdom*, para. 267.

<sup>162</sup> Tre llojet e situatave që përbëjnë shqetësim për detyrim të palejueshëm janë: (i) kur një i dyshuar detyrohet të dëshmojë nën kërcënimin e sanksioneve dhe, ose dëshmon për shkak të kësaj, ose sanksionohet ngaqë refuzon të dëshmojë; (ii) kur ushtrohet presion fizik ose psikologjik, shpesh në formën e një trajtimi që shkel nenin 3 të KEDNJ-së, për të siguruar dëshmi ose deklaratat reale; dhe (iii) kur autoritetet përdorin dredhi për të marrë informacione të cilat nuk kanë qenë në gjendje t’i marrin gjatë marrjes në pyetje. Shih, p.sh., *Ibrahim and Others v. The United Kingdom*, para. 267 dhe jurisprudenca e cituar aty.

vazhdojë të jetë e lirë të përcaktojë strategjinë e saj.<sup>163</sup> Megjithëse Paneli i ka parasysh vështirësitë e mundshme me të cilat mund të përballet Mbrojtja në këtë aspekt, Mbrojtja nuk ka asnjë detyrim t'i bëjë ato intervista dhe zgjedhja e pyetjeve mbetet tërësisht në dorë të saj.<sup>164</sup> Sipas mendimit të Panelit, megjithëse gjatë intervistës me dëshmitarin mund të zbulohet informacion inkriminues, kjo në vetvete nuk shkel të drejtën për gjykim të drejtë.<sup>165</sup> Rrjedhimisht, Paneli është bindur se Korniza nuk përmban asnjë element detyrimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që bie ndesh me të drejtën e mosinkriminimit të vetes.<sup>166</sup>

58. Paneli do të trajtojë tani argumentin e Mbrojtjes se mundësia e pranimit të intervistave në provat gjyqësore vetëm me autorizim gjyqësor nuk përbën garanci mbrojtëse të përshtatshme.<sup>167</sup> Ndonëse Paneli gjykon se ka njëfarë baze në argumentin e Mbrojtjes që ZPS-ja gjithsesi do njihet me atë material me gjasë inkriminues nëpërmjet pranisë së saj në intervista dhe/ose marrjes së transkripteve të incizimeve të tyre, sikurse konstatohet më lart, kjo situatë nuk përfshin asnjë formë detyrimi.<sup>168</sup> Për këtë arsye, dhe duke qenë se gjithsesi nuk është bërë asnjë shkelje, Paneli konstaton se nuk ishte e nevojshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të vlerësonte nëse Korniza përmbante garanci mbrojtëse të përshtatshme.<sup>169</sup> Rrjedhimisht, Paneli

<sup>163</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 150.

<sup>164</sup> Shih, p.sh., ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1235-Corr-Anx1, Annex I Decision on disclosure by the defence, 20 March 2008 ("*Lubanga* Decision on Disclosure by Defence"), para. 27 (ku konstatohet se të drejtat themelore të të akuzuarit për të mos inkriminuar veten dhe për të heshtur nuk duhet të cenohen nga asnjë detyrim të vendosur mbi mbrojtjen). Situata e tanishme është gjithashtu tërësisht e dallueshme nga liria e të dyshuarit apo të akuzuarit për të zgjedhur të flasë ose të heshtë kur merret në pyetje e cila mbrohet me të drejtën për të mos folur dhe me të drejtën e mosinkriminimit të vetes. Shih ECtHR, *Allan v. The United Kingdom*, no. 48539/99, Judgment, 5 November 2002, para. 50.

<sup>165</sup> Në të njëjtën mënyrë, asgjë nuk e mbron të akuzuarin nga rreziku i dhënies së provave inkriminuese nga dëshmitari gjatë marrjes në pyetje nga pala kundërshtare.

<sup>166</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 150, 154. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 160.

<sup>167</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 47.

<sup>168</sup> Paneli vëren se në bazë të Protokollit të GJPN-së, incizimet e intervistës duhet gjithashtu t'i vihen në dispozicion palës thirrëse. Shih Protokollin e GJPN-së, para. 41.

<sup>169</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 151-154.

nuk do të shqyrtojë përshtatshmërinë e garancive mbrojtëse që përcaktohen në Kornizë.

59. Në fund, Paneli e rrëzon menjëherë parashtrimin e Mbrojtjes se e drejta e mosinkrimimit të vetes përfshin edhe vetë dëshmitarët, sepse ajo nuk ka të drejtë të ngrejë pretendime të tilla në emër të dëshmitarëve.<sup>170</sup> Gjithsesi, sa i takon pretendimit për shkelje që ngre Mbrojtja në emër të tyre, Paneli nuk sheh se si Korniza do të çonte në shkelje të së drejtës së tyre.<sup>171</sup> Çdo parashtrim përtej kësaj del jashtë kuadrit të pikës së gjashtë të Krasniqit.<sup>172</sup>

60. Për këto arsye, Paneli nuk konstaton gabim në përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se Korniza nuk e shkel privilegjin e mosinkrimimit të vetes. Rrjedhimisht, rrëzohet kjo pjesë e Pikës 3 të Apelit të Krasniqit.

## **2. Nëse Korniza ndikon në privilegjin e komunikimit mbrojtës-klient (Pika A e Apelit të Thaçit, pjesërisht)**

### **(a) Parashtrimet e palëve**

61. Në Pikën A (që përkon me pikën e parë të Thaçit), Thaçi parashtron se masat e incizimit dhe nxjerrjes së intervistave me dëshmitarët të parashikuara në Kornizë shkelin privilegjin e komunikimit mbrojtës-klient sepse e bëjnë informacionin e mbrojtur – që rezulton prej informacionit të dhënë nga klienti – objekt të nxjerrjes për ZPS-në dhe Trupin Gjykses dhe me gjasë të pranueshëm si provë gjyqësore.<sup>173</sup> Thaçi argumenton se Mbrojtja vihet në “pozitën e pamundur”, ku i duhet të zgjedhë mes zbulimit të informacionit të mbrojtur, që mund të jetë relevant për mbrojtjen e të

---

<sup>170</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 49.

<sup>171</sup> Paneli vëren se Korniza përmban dispozita, në përputhje me rregullën 151(1) të Rregullores, për të siguruar që dëshmitarët të informohen se mund të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve nëse mendohen se mund të jenë me gjasë vetinkriminuese. Shih Kornizën, para. 212(II)(i)(ii).

<sup>172</sup> Shih më lart, para. 8(j).

<sup>173</sup> Apeli i Thaçit, para. 25-27. Shih edhe Apelin e Thaçit, para. 24, 37, 55; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 4, 10, 13. Krasniqi pretendon gjithashtu se ZPS-së do t'i zbuloheshin aspekte konfidenciale të komunikimeve të privileguara. Shih Apelin e Krasniqit, para. 4.

akuzuarit dhe humbjes së mundësive hetimore për të hedhur poshtë akuzat e ZPS-së.<sup>174</sup>

62. Sipas mendimit të Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që: (i) u mbështet në rregullën 111(1)(b) të Rregullores lidhur me nxjerrjen vullnetarisht të informacionit të privilegjuar për një palë të tretë; (ii) gjykoi se Mbrojtja vazhdonte të kishte “lirinë” të vlerësonte se cilin informacion të bëjë të ditur apo të fshehtë në lidhje me intervistat e dëshmitarëve që janë pjesë e Listës së Dëshmitarëve të ZPS-së; dhe (iii) u mbështet në faktin se aspektet e tjera të hetimeve të Mbrojtjes nuk ndikohen.<sup>175</sup>

63. Mbrojtësi i Viktimave dhe ZPS-ja përgjigjen se Korniza nuk shkel privilegjin e komunikimit mbrojtës-klient, që mbron vetëm komunikimet mes të akuzuarve dhe avokatëve të Mbrojtjes por nuk përfshin intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarë.<sup>176</sup> Ata parashtrojnë se kur një informacion, që fillimisht ishte privilegjuar, i bëhet i ditur një dëshmitari gjatë intervistës, ai nuk është më i privilegjuar.<sup>177</sup> Sipas mendimit të tyre, vendimi nëse dëshmitarit i bëhen pyetje në një mënyrë të tillë që zbulon informacion të privilegjuar përbën “zgjedhje” dhe Korniza nuk i vendos Mbrojtjes asnjë detyrim për ta bërë këtë.<sup>178</sup>

64. Thaçi kundërpërgjigjet se ZPS-ja anashkalon faktin se informacioni i privilegjuar do t’i bëhet i ditur jo vetëm dëshmitarit, por edhe ZPS-së dhe Trupit Gjykses.<sup>179</sup> Ai parashtron se Mbrojtësi i Viktimave ia “shtrembëron” parashtrimet,

---

<sup>174</sup> Apeli i Thaçit, para. 28-30; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 10. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 12.

<sup>175</sup> Apeli i Thaçit, para. 29-31, ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 157.

<sup>176</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 24-28; Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 69-71. Mbrojtësi i Viktimave shton se dëshmitarët nuk janë të detyruar t’i përmbahen parimit të komunikimit të privilegjuar mbrojtës-klient. Shih Përgjigjen e Mbrojtësit të Viktimave, para. 29.

<sup>177</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 28; Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 71.

<sup>178</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 30; Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 71.

<sup>179</sup> Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 10. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 11.

sepse ai nuk ishte shprehur që intervistat me dëshmitarët në vetvete janë të privilegjuara.<sup>180</sup>

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

65. Në fillim, Paneli rikujton se privilegji i komunikimit mbrojtës-klient mbrohet konkretisht nga neni 8 i GJEDNJ-së.<sup>181</sup> Ky privilegj, i garantuar nga rregulla 111(1) e Rregullores, ku përcaktohet që komunikimet midis të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij janë të privilegjuara dhe nuk janë objekt i nxjerrjes në mungesë të pëlqimit të klientit ose të zbulimit të informacionit vullnetarisht prej tij një pale të tretë, përfshihet edhe në nenin 30(5) të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 21(4) të Ligjit. Kjo është konsideruar jetike për mbrojtjen e të akuzuarit apo apeluesit, sepse mundëson komunikim të hapur midis mbrojtësit dhe klientit, që është i domosdoshëm për ofrimin e ndihmës ligjore efektive.<sup>182</sup>

66. Sipas Thaçit, Korniza shkel privilegjin e komunikimeve mbrojtës-klient sepse informacionin e privilegjuar – të dhënë nga klienti në kuadër të marrëdhënies profesionale me mbrojtësin – e bën objekt të nxjerrjes për ZPS-në dhe Trupin Gjykues.<sup>183</sup> Panelin nuk e bind pretendimi i Thaçit se privilegji i komunikimit mbrojtës-klient përfshin edhe intervistat që kryen Mbrojtja me dëshmitarë, për arsyet e mëposhtme.

67. Së pari, Thaçi nuk jep asnjë bazë për këtë parashtrim që nuk mbështetet as nga korniza ligjore e Dhomave të Specializuara dhe as nga jurisprudenca ndërkombëtare.<sup>184</sup> Së dyti, duke qenë se mbrojtësi merr vendim të peshuar për të intervistuar dëshmitarë në bazë të informacioneve që ka marrë nga i akuzuari, fakti se

---

<sup>180</sup> Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 11.

<sup>181</sup> ECtHR, *Michaud v. France*, no. 12323/11, Judgment, 6 December 2012, para. 118-119.

<sup>182</sup> Shih, p.sh., IRMCT, *Prosecutor v. Mladić*, MICT-13-56-A, Judgment, 8 June 2021, para. 98.

<sup>183</sup> Apeli i Thaçit, para. 25.

<sup>184</sup> Shih, p.sh., ICTY, *Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-A, Judgment, 15 July 1999 (“*Tadić* Appeal Judgment”), para. 325 (ku Dhoma e Apelit e TPNJ-së konfirmoi se konfidencialiteti i komunikimit mbrojtës-klient nuk mbulon deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve të mbrojtjes).



disa aspekte të këtyre komunikimeve zbulohen qëllimisht nuk përbën as shkelje të privilegjit të komunikimit mbrojtës-klient, as nxjerrje të komunikimeve të privileguara midis mbrojtësit dhe të akuzuarit. Faktikisht, në qoftë se gjatë intervistës me një dëshmitar mbrojtësi vendos t'i bazojë pyetjet në informacionet e dhëna nga i akuzuari, status të privileguar ka vetëm pjesa fillestare e procesit, domethënë komunikimi midis mbrojtësit dhe të akuzuarit. Sipas mendimit të Panelit, produkti i punës që më pas komunikohet gjatë intervistës nuk është më i privileguar, aq më tepër sepse ai i jepet një pale të tretë, që është dëshmitari. Mund të thuhet që e njëjta gjë vlen edhe për marrjet në pyetje të dëshmitarëve nga mbrojtësi – qoftë në cilësinë e palës thirrëse apo të palës kundërshtare – dhe për deklaratat e dëshmitarëve që ka gjasa të bazohen në informacione të dhëna nga i akuzuari në kuadër të komunikimeve të privileguara. Megjithatë, asnjë prej këtyre situatave nuk mbulohet nga privilegji i komunikimeve mbrojtës-klient.<sup>185</sup>

68. Në këtë kuptim, Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se i takon Mbrojtjes të vlerësojë se cilin informacion zgjedh të zbulojë apo të fshehë lidhur me individët që interviston gjatë hetimit të saj.<sup>186</sup> Rrjedhimisht, Paneli është bindur se Korniza nuk e shkel privilegjin e komunikimit mbrojtës-klient, pavarësisht nëse ky informacion i zbulohet jo vetëm dëshmitarit të intervistuar por edhe ZPS-së dhe Trupit Gjykes nëpërmjet dorëzimit të incizimeve të intervistave.

69. Paneli do të trajtojë tani nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që gjykoj se rregulla 111(1)(b) e Rregullores është e zbatueshme për intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarët sipas kushteve të Kornizës.<sup>187</sup> Sipas Panelit, kjo dispozitë parashikon një proces me dy hapa: (i) personi i bën të ditur vullnetarisht një pale të tretë përmbajtjen e komunikimit të privileguar; dhe (ii) *pas kësaj*, pala e tretë jep dëshmi për atë

---

<sup>185</sup> *Tadić* Appeal Judgement, para. 325.

<sup>186</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 157.

<sup>187</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 157.

informacion të nxjerrë.<sup>188</sup> Siç ka theksuar me të drejtë Mbrojtja, kushti që, *pas kësaj*, pala e tretë të japë dëshmi për komunikimet e privileguara që personi i ka nxjerrë vullnetarisht, nuk zbatohet në këto rrethana.<sup>189</sup> Paneli nuk është bindur që konteksti aktual përbën një situatë që përfshihet në rregullën 111(1)(b) të Rregullores, në kuptimin që dëshmitarët e intervistuar – pala e tretë sipas Gjykatësit të Procedurës Paraprake – nuk do të “jepnin dëshmi” për atë nxjerrje të pretenduar në kontekstin e intervistave me mbrojtësin.<sup>190</sup> Përkundrazi, siç konstatohet më lart, Paneli i Apelit gjykon se marrja në pyetje qëllimisht e një dëshmitari në bazë të informacioneve të siguruara nëpërmjet komunikimeve të privileguara me të akuzuarin nuk çon në *asnjë* nxjerrje informacioni të privilegjuar. Rrjedhimisht, Paneli nuk pajtohet me konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për zbatueshmërinë e rregullës 111(1)(b) të Rregullores në lidhje me intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarët sipas kushteve të Kornizës. Megjithatë, ky konstatim i gabuar i Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk zhvlerëson përfundimin e përgjithshëm se Korniza nuk përbën asnjë shkelje të privilegjit të komunikimit mbrojtës-klient.

70. Për këto arsye, rrëzohet kjo pjesë e Pikës A të Apelit të Thaçit.

### **3. Nëse Korniza shkel parimin e barazisë mes palëve dhe të drejtën për t’u përgatitur për gjykim (Pika A e Apelit të Thaçit, pjesërisht; Pika 3 e Apelit të Krasniqit, pjesërisht)**

71. Paneli i Apelit gjykon se një pjesë e Pikës A të Apelit të Thaçit (që përkon me pikën e parë të Thaçit) dhe një pjesë e Pikës 3 të Apelit të Krasniqit (që përkon me pikën e gjashtë të Krasniqit) kanë ngjashmëri të konsiderueshme, sepse të dyja kanë të bëjnë me pyetjen nëse Korniza shkel parimin e barazisë mes palëve dhe/ose të

<sup>188</sup> Rregulla 111(1)(b) e Rregullores parashikon që “personi i bën të njohur vullnetarisht përmbajtjen e komunikimeve një pale të tretë dhe pala e tretë më pas jep dëshmi për këtë nxjerrje”.

<sup>189</sup> Shih Apelin e Thaçit, para. 30.

<sup>190</sup> Krahaso SCSL, *Independent Counsel v. Bangura et al.*, SCSL-2011-02-T, Decision on Prosecutor’s Additional Statement of Anticipated Trial Issues and Request for Subpoena in Relation to the Principal Defender, 3 September 2012, para. 26-27.

drejtën për t'u përgatitur për gjykim. Rrjedhimisht, këto pika apeli do të shqyrtohen bashkërisht.

(a) Parashtrimet e palëve

72. Thaçi parashtron se mundësia që ai të kryejë hetime lidhur me provat kundër tij komprometohet nga masat e vendosura nga Korniza.<sup>191</sup> Ai argumenton se, ndërsa para vendosjes së Kornizës hetimet e tij ishin “të papenguara”, dëshmitarët të cilët atëherë bashkëpunonin, tani “nuk lejohet të kontaktohen”.<sup>192</sup> Thaçi thekson gjithashtu ndikimin e saj në kryerjen e shpejtë të procesit.<sup>193</sup> Sipas mendimit të tij, prania e ZPS-së dhe marrja e incizimeve të intervistave nga Trupi Gjykses “u merr frymën” hetimeve, çka e detyron Mbrojtjen të kryejë – ose të refuzojë të kryejë – intervista “të kufizuara dhe të kujdesshme” për të shmangur marrjen e informacioneve inkriminuese, në vend që “marrja në pyetje të jetë e hapur dhe e pakufizuar”.<sup>194</sup> Në fund, Thaçi parashtron se kërkesat “revolucionare” të incizimit dhe nxjerrjes janë aspektet “më problematike” të Kornizës, sepse eliminojnë garancitë mbrojtëse që rregullojnë pranueshmërinë e provave.<sup>195</sup>

73. Në mënyrë të ngjashme, Krasniqi argumenton se këta mekanizma të vendosur nga Korniza e detyrojnë Mbrojtjen t'i ndryshojë strategjitë hetimore të saj.<sup>196</sup> Krasniqi parashtron gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se Korniza nuk e shkel parimin e barazisë mes palëve.<sup>197</sup> Sipas tij, Korniza e ngarkon Mbrojtjen me një barrë “asimetrike” dhe “shumë më të madhe” përmes vendosjes së

---

<sup>191</sup> Apeli i Thaçit, para. 24, 32, 34. Shih edhe Apelin e Thaçit, para. 6-7, 35, 37; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 4, 13-14.

<sup>192</sup> Apeli i Thaçit, para. 33-34. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 4, 13.

<sup>193</sup> Apeli i Thaçit, para. 34. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 6; Apeli i Krasniqit, para. 29, 33.

<sup>194</sup> Apeli i Thaçit, para. 24, 35. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 13; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 19. Thaçi shton se këto masa “me gjasë do të dekurajojnë” dëshmitarët me status të dyfishtë dhe të dyshuarit që të bashkëpunojnë me Mbrojtjen. Shih Apelin e Thaçit, para. 36.

<sup>195</sup> Apeli i Thaçit, para. 37.

<sup>196</sup> Apeli i Krasniqit, para. 48. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 19.

<sup>197</sup> Apeli i Krasniqit, para. 45, 50-51, ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 141, 144. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 22-23; Apeli i Thaçit, para. 6, 32, 54.

“vonesave administrative dhe ndërlikimeve logjistike”, të cilat ZPS-ja nuk i ka pasur, sepse i përfundoi hetimet para miratimit të Kornizës.<sup>198</sup>

74. ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gaboi që konstatoi se Korniza nuk e shkel barazinë mes palëve apo të drejtat e Mbrojtjes për t’u përgatitur dhe thekson se ajo zbatohet njësoj si për Mbrojtjen ashtu edhe për ZPS-në.<sup>199</sup> Sipas mendimit të ZPS-së, Mbrojtja nuk ka “të drejtë të pakufizuar” sipas Ligjit ose Rregullores që të kryejë intervista me dëshmitarë sipas kushteve të veta.<sup>200</sup> ZPS-ja argumenton gjithashtu se Mbrojtja nuk bën dallimin midis mandateve dhe roleve të ZPS-së dhe të Mbrojtjes.<sup>201</sup> Në fund, ZPS-ja kundërshton parashtrimin e Mbrojtjes sipas të cilit Korniza anashkalon procedurën normale për pranueshmërinë.<sup>202</sup>

75. Mbrojtësi i Viktimave gjithashtu parashtron se Korniza zbatohet njësoj edhe për ZPS-në dhe thekson se, në kohën kur ZPS-ja kreu intervistat e saj, nuk kishte “të akuzuar që të ftoheshin” për të qenë të pranishëm në to.<sup>203</sup> Ai parashtron gjithashtu se Mbrojtja nuk arrin të demonstrojë se Korniza do të vononte hetimet Mbrojtjes.<sup>204</sup>

76. Krasniqi kundërpërgjigjet se fakti që mbrojtësit e të akuzuarve nuk ishin caktuar ende gjatë pjesës më të madhe të hetimeve të ZPS-së në fakt ilustron padrejtësinë e Vendimit të Kundërshtuar.<sup>205</sup> Gjithashtu, Krasniqi kundërshton parashtrimin e ZPS-së sipas të cilit edhe hetimet e saj lidhur me dëshmitarët e Mbrojtjes do të kryhen sipas Kornizës, duke qenë se Mbrojtja nuk ka detyrimin e

---

<sup>198</sup> Apeli i Krasniqit, para. 50-51. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 29, 33; Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 22-23.

<sup>199</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 72-74. Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 76.

<sup>200</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 72.

<sup>201</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 74.

<sup>202</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 77. Shih edhe Përgjigjen e Mbrojtësit të Viktimave, para. 38.

<sup>203</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 43.

<sup>204</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 42, ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 165.

<sup>205</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 22.

vërtetimit apo detyrimin për të paraqitur prova të mirëfillta, dhe numri i dëshmitarëve të Mbrojtjes me gjasë do të jetë shumë më i vogël.<sup>206</sup>

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

77. Së pari, lidhur me barazinë mes palëve dhe pyetjen nëse Korniza i ngarkon Mbrojtjes një barrë joproporcionale, Paneli rikujton se sipas parimit të barazisë mes palëve, siç përcaktohet në jurisprudencën e GJEDNJ-së, secilës palë i duhet dhënë mundësi e arsyeshme të paraqesë provat e veta në kushte që nuk e vendosin në pozitë të pafavorshme kundrejt kundërshtarit.<sup>207</sup> Paneli vëren se Korniza, sikurse ka vërejtur Gjykatësi i Procedurës Paraprake, është formuluar me terma të përgjithshme dhe asnjënjë dhe, si e tillë, nuk i drejtohet vetëm një pale të caktuar por të dyja palëve në mënyrë të barabartë.<sup>208</sup> Në arritjen e këtij konstatimi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti parasysh se Mbrojtja nuk është e detyruar të paraqesë prova dhe se, vetëm nëse Mbrojtja vendos ta bëjë këtë, Korniza efektivisht do të zbatohet për intervistat e ZPS-së me dëshmitarët e Mbrojtjes. Sipas mendimit të Panelit, aspektet nëse Mbrojtja do të paraqesë prova apo nëse numri i dëshmitarëve të Mbrojtjes ka gjasë të jetë më i vogël, nuk kanë lidhje me faktin se Korniza është hartuar për t'u zbatuar pa dallim. Ndonëse e pranon se numri i dëshmitarëve mund të shkaktojë njëfarë asimetrie, Paneli konstaton se në rast se Mbrojtja do të paraqesë prova, Korniza do të funksionojë në të njëjtat rrethana si edhe për intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarët e ZPS-së dhe nuk do ta vendosë ZPS-në në ndonjë pozitë veçanërisht të favorshme ose Mbrojtjen në ndonjë pozitë veçanërisht të pafavorshme sa i takon barazisë së palëve.<sup>209</sup> Po kështu, Paneli konstaton se Mbrojtja nuk arrin të demonstrojë se si Korniza vë në dyshim

<sup>206</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 23. Shih edhe Apelin e Krasniqit, para. 51.

<sup>207</sup> Shih ECtHR, *Foucher v. France*, no. 22209/93, Judgment, 18 March 1997, para. 34, cituar në Vendimin e Kundërshtuar, para. 138. Shih edhe, p.sh., KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017 Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05-L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 26 prill 2017, para. 27; Vendimi mbi Apelin e Haradinajt, para. 43; ICTR, *Nahimana et al. v. Prosecutor*, ICTR-99-52-A, Judgment, 28 November 2007, para. 181.

<sup>208</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 144.

<sup>209</sup> *Contra* Apeli i Krasniqit, para. 50-51.

parimin se ZPS-ja ka detyrimin e vërtetimit dhe rikujton konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se Korniza nuk mund të interpretohet si zhvendosje e këtij detyrimi tek pala tjetër.<sup>210</sup>

78. Sa i takon kohës së miratimit të Kornizës, Paneli e gjykon jobindës argumentin e Mbrojtjes se fakti që ZPS-ja i kishte përfunduar hetimet e veta përpara miratimit të Kornizës e vendos Mbrojtjen në pozitë të pafavorshme kundrejt ZPS-së për shkak se: (i) ndonëse Mbrojtja nuk ishte e pranishme gjatë intervistave të ZPS-së me dëshmitarë, nuk ekziston e drejta që një palë të jetë e pranishme në çdo intervistë të dëshmitarëve të saj me palën kundërshtare; dhe (ii) në këtë fazë, ZPS-ja nuk ka marrë njoftim për asnjë dëshmitar të Mbrojtjes – në rast se të akuzuarit vendosin të paraqesin prova<sup>211</sup> – ndaj, logjikisht, ZPS-ja nuk ka filluar asnjë hetim përkatës. Krahas kësaj, Paneli rikujton se Mbrojtja mund të bëjë kërkesë për mjet juridik ose ndryshim të Kornizës sipas rastit.<sup>212</sup> Rrjedhimisht, Paneli konstaton se të akuzuarit nuk kanë demonstruar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që arriti në përfundimin se Korniza nuk shkel parimin e barazisë mes palëve.<sup>213</sup>

79. Sa i përket pyetjes nëse Korniza komprometon të drejtën e të akuzuarve për të kryer hetime lidhur me provat kundër tyre, Paneli fillimisht vëren se parashtrimet e Mbrojtjes duket se rrjedhin nga supozimi i gabuar se ekziston automatikisht e drejta e pakufizuar për të kryer intervista me dëshmitarët e palës kundërshtare. Në fakt, në kornizën ligjore e Dhomave të Specializuara nuk pasqyrohet kjo e drejtë. Është e vërtetë që jurisprudenca e tribunalëve *ad hoc* ka pranuar se Mbrojtja mund të ketë interes legjitim për të marrë në pyetje një dëshmitar të Prokurorisë për të përgatitur

---

<sup>210</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 144. Shih Apelin e Krasniqit, para. 51.

<sup>211</sup> Shih F01050/RED, Version i Redaktuar Publik i Dosjes Paraprake të z. Hashim Thaçi, 8 nëntor 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 21 tetor 2022), para. 17; F01052, Dosja Paraprake e Mbrojtjes së Kadri Veselit, me Shtojcat Konfidenciale 1-3, 22 tetor 2022 (konfidenciale), para. 3; F01049, Dosja Paraprake e Mbrojtjes së Selimit, 21 tetor 2022 (konfidenciale), para. 182; F01051, Dosja Paraprake e Jakup Krasniqit, 21 tetor 2022 (konfidenciale), para. 6.

<sup>212</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 151, 175.

<sup>213</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 144-145.



siç duhet provat e veta,<sup>214</sup> por kjo nuk mbështet qëndrimin se Mbrojtja ka të drejtë të vetvetishme për t'i kryer ato intervista.<sup>215</sup> Faktikisht, edhe pse TPNJ-ja dhe TPNR-ja nuk kishin praktika të harmonizuara në këtë aspekt, kontakte të tilla u kryen gjithmonë në kuadër të procedurave të veçanta dhe në shumë raste, edhe vetëm mundësia e intervistimit të dëshmitarëve të palës kundërshtare ishte objekt i autorizimit gjyqësor dhe kërkonte demonstrimin e arsyeve të vlefshme dhe/ose nënkuptonte praninë e palës kundërshtare.<sup>216</sup> Në ndryshim nga kjo, sipas Kornizës

<sup>214</sup> Shih ICTY, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-AR73, Decision on the Issuance of Subpoenas, 21 June 2004, para. 12. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 163.

<sup>215</sup> Shih, p.sh., ICTY, *Prosecutor v. Mrkšić*, IT-95-13/1-AR73, Decision on Defence Interlocutory Appeal on Communication with Potential Witnesses of the Opposite Party, 30 July 2003, para. 13 (ku theksohet se liria për të kontaktuar dëshmitarë të mundshëm nuk është pa kufizime); *Niyitegeka* Decision, para. 8 (ku konstatohet se kontakte të tilla duhet të ndjekin një procedurë specifike). Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 163.

<sup>216</sup> Shih, p.sh., *Ndindiliyimana et al.* Decision, para. 3-5 (që miratoi kërkesën e mbrojtjes për t'u takuar me një dëshmitar të prokurorisë në prani të një përfaqësuesi të prokurorisë, sepse kishte "arsye të vlefshme" për këtë); ICTR, *Prosecutor v. Bizimungu et al.*, ICTR-99-50-T, Decision on Jérôme-Clément Bicamumpaka's Motion Requesting Recall of Prosecution Witness GFA; Disclosure of Exculpatory Material; and to Meet with Witness GFA, 21 April 2008, para. 14-16 (që miratoi kërkesën kërkesa e mbrojtjes për t'u takuar me një dëshmitar të prokurorisë në prani të prokurorisë, sepse Mbrojtja kishte vërtetuar ekzistencën e interesit legjitim për këtë); ICTR, *Prosecutor v. Ndindiliyimana et al.*, ICTR-2000-56-T, Decision on Sagahutu's Motion for Reconsideration of 19 March 2004 Decision on Disclosure of Prosecution Materials, for Leave to Contact a Prosecution Witness, and for Access to Testimony of Protected Witnesses in the Military I Case, 3 November 2004, para. 23 (që miratoi kërkesën e mbrojtjes për t'u takuar me një dëshmitar të prokurorisë, me kusht që dëshmitari të jepte pëlqimin, dhe lejoi praninë e një përfaqësuesi të prokurorisë); ICTR, *Prosecutor v. Nzabonimana*, ICTR-98-44D-PT, Decision on Motion to Interview Prosecution Witnesses, 24 August 2009, para. 1, 9-10 (që konstatoi se mbrojtja kishte vërtetuar ekzistencën e arsyeve të vlefshme për intervistimin e dëshmitarëve të prokurorisë dhe miratoi kërkesën e mbrojtjes për kryerjen e saj, duke konstatuar se prokuroria mund të ishte e pranishme në intervistat e dëshmitarëve të mbetur në listën e dëshmitarëve të saj); ICTR, *Prosecutor v. Ngirabatware*, ICTR-99-54-T, Decision on Defence Motion for Leave to Meet with the Husband of Witness ANAE and for Postponement of her Testimony, 28 October 2009, para. 21-22 (që miratoi pjesërisht kërkesën e mbrojtjes për t'u takuar me bashkëshortin e një dëshmitareje të prokurorisë dhe njëkohësisht miratoi kërkesën e prokurorisë për të qenë e pranishme gjatë takimit); ICTR, *Prosecutor v. Bizimungu et al.*, ICTR-99-50-T, Decision on Prosper Mugiraneza's Motion to Vary Restrictions in the Trial Chamber's Decision of 2 October 2003 Related to Access Jean Kambanda, 24 August 2004, para. 19-21 (që miratoi kërkesën e mbrojtjes për heqjen e kufizimeve fillestare dhe për intervistimin e një dëshmitari të prokurorisë pa praninë e përfaqësuesit të prokurorisë, duke vërejtur se kjo prani mund ta bënte të pamundur intervistën); *Niyitegeka* Decision, para. 15-17 (që miratoi kërkesën e prokurorisë për të kontaktuar 25 dëshmitarë të mbrojtjes dhe konstatoi se mbrojtja mund të ishte e pranishme në këto intervista nëse dëshironte); ICTR, *Prosecutor v. Kanyabashi*, ICTR-96-15-T, Decision on Joseph Kanyabashi's Request to Meet SW and FAT and All Other Persons Whose Identities Were Not Disclosed to Defence, 23 November 2004, para. 11-13 (që miratoi kërkesën e mbrojtjes për t'u takuar me dy dëshmitarë të prokurorisë në mungesë të prokurorisë nëse dëshmitarët pajtoheshin me këtë, dhe vuri në dukje pëlqimin e prokurorisë). Në raste të tjera, megjithëse marrja paraprakisht e autorizimit

aktuale, Mbrojtjes i lejohet shprehimisht t'i kryejë këto intervista pa qenë nevoja të kërkojë leje paraprake nga gjykatësi.

80. Paneli pajtohet gjithashtu me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se kryerja e intervistave me dëshmitarë të palës kundërshtare është një aspekt i ndryshëm dhe nuk vë në dyshim të drejtën themelore të të akuzuarit që mishërohet në nenin 21(4)(f) të Ligjit si edhe në nenin 6(3)(d) të KEDNJ-së, që të marrë në pyetje vetë, ose të merren në pyetje në emër të tij, dëshmitarët kundër tij dhe që të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet në kushte të njëjta si dëshmitarët e akuzës.<sup>217</sup> Nuk vihet në diskutim se mundësia e Mbrojtjes për t'u bërë pyetje në gjykim dëshmitarëve në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së nuk ndikohet aspak nga Korniza.<sup>218</sup>

81. Nga sa më sipër rrjedh se nuk ekziston e drejta e pakufizuar për të intervistuar dëshmitarë të palës kundërshtare dhe se, ndryshe nga çfarë parashtron Mbrojtja, është

---

gjyqësor nuk ishte e detyruar, prania e përfaqësuesit të palës kundërshtare ishte parashikuar. Shih, p.sh., *Ngirabatware* Decision, f. 9(v) (ku u konstatua se prokuroria mund të kontaktonte dëshmitarë të mundshëm të mbrojtjes, me njoftim paraprak të mbrojtjes dhe në praninë e një përfaqësuesi të mbrojtjes); ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Decision in Interview of Defence Witnesses by the Prosecution, 8 November 2012, para. 16(c) (në lidhje me intervistat e prokurorisë me dëshmitarët e mbrojtjes, që parashikoi mundësinë që dëshmitarët të kërkonin praninë e një përfaqësuesi të të akuzuarit); ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-PT, Decision on Motion for Reconsideration of Decision on Motion for Order for Contact with Prosecution Witnesses, 15 July 2009, para. 8, 11 (në lidhje me intervistat e të akuzuarit me dëshmitarë të prokurorisë, që parashikoi mundësinë që dëshmitarët të kërkonin praninë e një përfaqësuesi të prokurorisë); ICTY, *Prosecutor v. Prcać*, IT-98-30/1, Decision on Prosecution Motion for Protective Measures and Particularly for Witness N, 14 April 2000, para. 3-4 (që konstatoi se i akuzuari dhe prokuroria i kontaktojnë dëshmitarët e palës kundërshtare pas njoftimit paraprak me shkrim dhe se një përfaqësues i palës kundërshtare mund të jetë i pranishëm gjatë takimit nëse këtë e kërkon dëshmitari). Shih edhe *Lubanga* Order Regulating Contacts with Witnesses, para. 11 (që konstatoi se pala ose pjesëmarrësi që thërret dëshmitarin për të dëshmuar ka të drejtë të ketë një përfaqësues të pranishëm gjatë intervistës). Në disa raste të tjera, takime të tilla mund të zhvilloheshin edhe pa praninë e palës kundërshtare, por në prani të një përfaqësuesi të zyrës administrative. Shih, p.sh., ICTR, *Prosecutor v. Karemera et al.*, ICTR-98-44-T, Decision on Reconsideration of Protective Measures Orders, 15 October 2009, para. 14-15.

<sup>217</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 163. *Contra* Apeli i Thaçit, para. 31-32. Sa u takon Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit në të cilat është mbështetur ai në apel, Paneli nuk do t'i shqyrtojë këto argumente sepse ato nuk u shqyrjuan nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ngaqë ishin pa bazë ligjore ose autorizim. Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 110; Apeli i Thaçit, para. 31, poshtëshënimi 39, që u referohet, ndër të tjera, Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit, para. 10. Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse e ZPS-së, para. 60.

<sup>218</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 162.

pranuar gjerësisht se mund të vendosen kushte për rregullimin e atyre kontakteve. Sipas Panelit të Apelit, varësisht garancive mbrojtëse të domosdoshme dhe proporcionale, Korniza në fakt i ofron Mbrojtjes një mundësi *shitesë* për të siguruar informacione të rëndësishme për përgatitjen e saj për gjykim,<sup>219</sup> krahas mundësive të tjera hetimore që ka Mbrojtja, siç është mundësia për të marrë në pyetje – jashtë kuadrit të Kornizës –individët që nuk janë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së apo ndryshe të njoftuar, apo mundësia për të hetuar aspekte të lidhura me dëshmitarët e ZPS-së përmes mënyrave të tjera veç intervistave.

82. Lidhur me kundërshtimin e Mbrojtjes ndaj theksimit që i bën Vendimi i Kundërshtuar faktit se ajo do të vazhdojë të jetë e lirë të përcaktojë strategjinë e saj,<sup>220</sup> Paneli rikujton konstatimin e tij më lart se Mbrojtja ka kontroll të plotë të vendosë se çfarë të zbulojë ose të fshehë gjatë këtyre intervistave, si edhe nëse do t'i kryejë ose jo ato intervista.<sup>221</sup> Ky është një vlerësim balancues që mund të bëhet vetëm nga Mbrojtja në kuadër të strategjisë së saj. Nëse Mbrojtja vlerëson se rreziku i marrjes së informacioneve inkriminuese nëpërmjet këtyre intervistave është tepër i lartë, janë të disponueshme mundësi hetimore të tjera.

83. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit nuk bindet se kushtet e vendosura në Kornizë pengojnë mundësinë e Mbrojtjes për të hetuar dhe për të mbledhur prova të favorshme për të akuzuarit.<sup>222</sup> Për këto arsye, Paneli është bindur se çfarëdo kufizimesh që mund të krijohen nga Korniza lidhur me mundësinë e të akuzuarve për të organizuar mbrojtjen e tyre në mënyrë të përshtatshme, nuk do të ishin në shkelje të nenit 6(3)(b) të KEDNJ-së.<sup>223</sup>

<sup>219</sup> Shih, p.sh., ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-2192-Red, Redacted Second Decision on disclosure by the defence and Decision on whether the prosecution may contact defence witnesses, 20 January 2010 (“*Lubanga Decision on Contacts with Defence Witnesses*”), para. 49.

<sup>220</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 150, 157, 162.

<sup>221</sup> Shih më lart, para. 56, 68.

<sup>222</sup> Shih, p.sh., *Dayanan v. Turkey*, para. 32, cituar në Apelin e Krasniqit, para. 19, poshtëshënimi 28.

<sup>223</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 162, ku i referohet ECtHR, *Mayzit v. Russia*, no. 63378/00, Judgment, 20 January 2005, para. 78 (ku konstatohet se i akuzuari duhet të ketë mundësinë ta organizojë mbrojtjen

84. Sa i takon pretendimit për ndikimin e Kornizës në kryerjen e shpejtë të procesit, Paneli vëren se, ndonëse të akuzuarit pretendojnë se Korniza do të shkaktojë medoemos ca vonesa,<sup>224</sup> përveçse bëjnë këtë pohim të përgjithshëm, ata nuk identifikojnë asnjë shembull konkret ku vonesa mund të thuhet se është shkaktuar nga masat e Kornizës. Paneli i konstaton këto pretendime si të pabaza dhe hipotetike në këtë fazë<sup>225</sup> dhe nuk sheh asnjë gabim në konstatimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake që në këtë fazë të procesit nuk mund të përcaktohet ndikimi i Kornizës mbi vlerësimin e përgjithshëm të kohëzgjatjes së procesit.<sup>226</sup>

85. Së fundi, Paneli rrëzon argumentin e Mbrojtjes se pranimi në prova i incizimeve të intervistave të nxjerra sipas Kornizës do të shkelte garancitë mbrojtëse ekzistuese për pranueshmërinë, për arsye se ai shpërfill faktin se gjithsesi do të ishin të zbatueshme kriteret normale që rregullojnë pranueshmërinë e provave në bazë të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara<sup>227</sup> dhe, vetëm “nëse [këto] kriterë përmbushen” atëherë Paneli, *proprio motu* ose me kërkesë të një pale, mund të vendosë të pranojë prova sikurse konfirmohet nga formulimet e përdorura shprehimisht në Kornizë.<sup>228</sup> Megjithëse Paneli vëren se kjo mundësi do të tejkalonte atë që parashihet,

---

e tij në mënyrën e duhur dhe pa kufizime të mundësisë për t’i paraqitur të gjitha argumentet mbrojtëse relevante para Trupit Gjykues dhe, rrjedhimisht, për të pasur ndikim në rezultatin e procesit). Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 176.

<sup>224</sup> Shih Apelin e Thaçit, para. 34; Apeli i Krasniqit, para. 29; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 6. Paneli vëren se Selimi argumenton gjithashtu se Korniza ndikon negativisht në të drejtat e Mbrojtjes për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për t’u përgatitur dhe për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Shih Apelin e Selimit, para. 25.

<sup>225</sup> E njëjta vlen për pretendimin e përsëritur të Thaçit se Korniza ka efekt dekurajues te dëshmitarët. Shih Apelin e Thaçit, para. 34. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 141.

<sup>226</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 165. Shih edhe Vendimin e Kundërshtuar, para. 125.

<sup>227</sup> Shih, p.sh., rregullat 137 dhe 138 të Rregullores.

<sup>228</sup> Shih Kornizën, para. 212(II)(o). *Contra* Apeli i Thaçit, para. 37. Shih edhe Apelin e Thaçit, para. 24 (ku pretendohet se incizimet mund të bëhen “automatikisht” pjesë e dokumentacionit zyrtar të çështjes). Rregulla e përgjithshme është se incizimet *nuk* duhen bërë pjesë e dokumentacionit të çështjes gjyqësore *përveç nëse* paneli vendos ndryshe. Shih Kornizën, para. 212(II)(o) (theksimi i shtuar).

për shembull, në Protokollin e GJPN-së,<sup>229</sup> ai nuk konstaton asnjë gabim në mënyrën si e ushtroi diskrecionin Gjykatësi i Procedurës Paraprake për miratimin e kësaj mase.<sup>230</sup>

86. Mbështetur në sa më lart, rrëzohen pjesët e mbetura të Pikës A të Apelit të Thaçit dhe Pikës 3 të Apelit të Krasniqit.

**4. Nëse masat e incizimit dhe nxjerrjes të parashikuara në Kornizë janë në shkelje të sistemit të nxjerrjes të materialeve të Dhomave Specializuara (Pika C e Apelit të Thaçit; Pika 2 e Apelit të Selimit)**

87. Paneli i Gjykatës së Apelit gjykon se Pika C e Apelit të Thaçit (që përkon me pikën e tetë të Thaçit) është e njëjtë me Pikën 2 e Apelit të Selimit (që përkon me pikën e katërt të Selimit), sepse që të dyja vënë në pikëpyetje nëse kërkesat për incizimin dhe nxjerrjen janë të domosdoshme dhe në përputhje me sistemin e nxjerrjes së materialeve të Dhomave të Specializuara.<sup>231</sup> Rrjedhimisht, këto pika apeli do të shqyrtohen bashkërisht.

(a) Parashtrimet e palëve

88. Thaçi parashtroi se, megjithëse në këtë fazë të procesit Mbrojtja nuk ka detyrimin të nxjerrë prova – sepse ato detyrime lindin vetëm pas përfundimit të paraqitjes së provave të ZPS-së – Korniza kërkon që Mbrojtja të nxjerrë deklaratat e dëshmitarëve të ZPS-së që do t'i intervistojë përpara se Mbrojtja të vendosë nëse do të paraqesë provat e saj dhe përpara se të dëgjojë provat e ZPS-së, në shkelje të rregullës 104(5) të Rregullores.<sup>232</sup> Sipas tij, kjo është e papajtueshme me sistemin e nxjerrjes së materialeve në Dhomat e Specializuara të përshkruar në rregullat 104 deri 111 të Rregullores dhe komprometon detyrimin e vërtetimit të akuzave dhe prezumimin e

<sup>229</sup> Shih më lart, para.30, poshtëshënimi 77.

<sup>230</sup> Kjo masë parashikohet edhe në Protokollin e Çështjes 07. Shih Protokollin e Çështjes 07, para. 40.

<sup>231</sup> Shih edhe Vendimin mbi Lejen për Apelin, para. 46 (ku këto pika janë trajtuar së bashku).

<sup>232</sup> Apeli i Thaçit, para. 47-48, 53. Shih edhe Apelin e Thaçit, para. 50; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 15, 17. Krasniqi argumenton gjithashtu se masa të tilla e detyrojnë Mbrojtjen t'i nxjerrë prova ZPS-së në shkelje të sistemit normal të nxjerrjes së materialeve. Shih Apelin e Krasniqit, para. 32.



pafajësisë.<sup>233</sup> Thaçi argumenton se, në rast se ZPS-ja vendos të mos thërrasë dëshmitarë të cilët më pas thirren nga Mbrojtja, atëherë atij do t'i duhet t'i thërrasë ata dëshmitarë kur ZPS-ja i ka pasur deklaratat e tyre "ndoshta prej vitesh".<sup>234</sup> Ai thekson se në dallim nga ajo që thotë Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ky "realitet" nuk është aspak hamendësues, duke argumentuar se Lista e Dëshmitarëve e ZPS-së është përpiluar "pa pëlqimin, madje edhe pa dijeninë" e disa prej dëshmitarëve të përfshirë në të.<sup>235</sup>

89. Selimi parashtron se incizimi dhe nxjerrja e detyrueshme e intervistave të dëshmitarëve janë të panevojshme dhe nuk janë proporcionale me qëllimet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe ruajtjes së provave, si edhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake shpërdoroi diskrecionin sepse nuk mori parasysh masa më pak kufizuese për zvogëlimin e rreziqeve të identifikuar.<sup>236</sup> Ai parashtron se Korniza, siç është formuluar, e vë Mbrojtjen para "mëdyshjes" për të zgjedhur midis ndërmarrjes së rrezikut që informacioni t'i zbulohet palës kundërshtare dhe detyrimit për të përgatitur plotësisht mbrojtjen, pavarësisht nëse janë ngritur pretendime për shkelje ose jo.<sup>237</sup> Selimi shton se kërkesa e autorizimit gjyqësor për të qenë të pranishëm në intervistë kundër parapëlqimit të dëshmitarit bie ndesh me vetë qëllimin e autorizimit gjyqësor.<sup>238</sup> Sipas Selimit, Zyra Administrative duhej të ishte caktuar kujdestare "asnjanëse" e intervistave të incizuara të ruajtura nën vulë, tek të cilat palët ose trupi gjykues mund të kishin qasje "nëse paraqiten shkaqe të arsyeshme për të dyshuar shkelje".<sup>239</sup> Sipas mendimit të Selimit, ky ndryshim i Kornizës do të ofronte të njëjtën

---

<sup>233</sup> Apeli i Thaçit, para. 46, 49, 53. Shih edhe Apelin e Thaçit, para. 55; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 15-16.

<sup>234</sup> Apeli i Thaçit, para. 50-51.

<sup>235</sup> Apeli i Thaçit, para. 51-52, ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 159.

<sup>236</sup> Apeli i Selimit, para. 4, 28-30, 37. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 33, 45-46; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 12, 17.

<sup>237</sup> Apeli i Selimit, para. 35-38, 42. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 41; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 18.

<sup>238</sup> Apeli i Selimit, para. 44. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 34, 40, 42; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 13-17, 19.

<sup>239</sup> Apeli i Selimit, para. 4, 28, 37, 39. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 40-41, 45-46; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 13. Selimi argumenton gjithashtu se ndikimi në burimet e Zyrës Administrative do të ishte minimal. Shih Apelin e Selimit, para. 43.



shkallë mbrojtjeje dhe njëkohësisht do të zbuste shqetësimet e Mbrojtjes dhe nuk do të ndërhynte në hetimet e saj.<sup>240</sup>

90. Në lidhje me Pikën C të Apelit të Thaçit, Mbrojtësi i Viktimave përgjigjet se ajo që jepet me dorëzimin e kopjes së incizimit është *incizimi* i intervistës me dëshmitarin, pra “diçka krejt e ndryshme” nga materiali që dorëzohet sipas rregullës 104 të Rregullores.<sup>241</sup>

91. ZPS-ja përgjigjet se ndonëse rregulla 104 e Rregullores parashikon disa nxjerrje të detyrueshme materialesh me afate të caktuara, ajo nuk ndalon nxjerrje të tjera materialesh në çfarëdo faze, në qoftë se jepet urdhër.<sup>242</sup> ZPS-ja parashtron se Thaçi shpërfill faktin se, sipas Rregullores, Mbrojtja duhet të nxjerrë materiale në procedurë paraprake në disa rrethana të caktuara dhe përmend jurisprudencën ndërkombëtare në mbështetje të kësaj.<sup>243</sup> Sipas ZPS-së, skenari hipotetik i paraqitur nga Thaçi, përveçse është tërësisht hamendësues, nuk përbën shkelje të rregullës 104(5) dhe (6) të Rregullores, që nuk ndalon caktimin e afateve më të hershme për nxjerrjen e materialeve.<sup>244</sup>

92. Mbrojtësi i Viktimave dhe ZPS-ja përgjigjen se parashtrimet e Selimit duhen rrëzuar pa u marrë në shqyrtim ngaqë nuk u ngritën asnjëherë në shkallë të parë.<sup>245</sup> ZPS-ja parashtron gjithashtu se Selimi kërkon në mënyrë të palejueshme që të zëvendësojë diskrecionin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake me diskrecionin e vet.<sup>246</sup>

---

<sup>240</sup> Apeli i Selimit, para. 38-39, 42. Shih edhe Apelin e Selimit, para. 34, 45-46; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 18.

<sup>241</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 41.

<sup>242</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 79.

<sup>243</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 79, poshtëshënimet 183-184, ku u referohet rregullave 95(5) dhe 104(1) të Rregullores dhe jurisprudenca e cituar aty. ZPS-ja shton se këto masa janë përfshirë edhe në Protokollin e GJPN-së dhe në Protokollin e Çështjes 07. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 79.

<sup>244</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 80.

<sup>245</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 40; Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 57.

<sup>246</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 57.

93. Thaçi kundërpërgjigjet se qëndrimi i ZPS-së se nuk janë të ndaluara afate më të hershme të nxjerrjes së materialeve është “tërësisht në mospërputhje” me parimet që rregullojnë proceset penale dhe të drejtën e të akuzuarit për të heshtur.<sup>247</sup> Ai kundërshton parashtrimin e ZPS-së se, sipas Rregullores, nxjerrja e materialeve nga Mbrojtja në procedurë paraprake “është e detyrueshme” në rrethana të caktuara sipas Rregullores.<sup>248</sup> Sipas Thaçit, masat e incizimit dhe nxjerrjes kanë të njëjtin “efekt praktik” me detyrimet e nxjerrjes të parashikuara në rregullën 104 të Rregullores – domethënë detyrimin për të nxjerrë “incizimin e plotë” të intervistave të dëshmitarëve që mund t’i thërrasë më pas, ndërkohë që Mbrojtja nuk e ka atë detyrim sipas Rregullores.<sup>249</sup>

94. Selimi kundërpërgjigjet se parashtrimet e tij në apel janë të përshtatshme sepse ai kërkon “zbatimin e barabartë të garancive mbrojtëse gjyqësore në të gjithë Kornizën”.<sup>250</sup> Sipas Selimit, duke qenë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykoj se lejimi i ZPS-së të jetë e pranishme në çdo intervistë pavarësisht nga parapëlqimi i shprehur prej dëshmitarit do t’i tejkalojë kufijtë e synimeve të deklaruara të Kornizës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ushtroi diskrecionin e tij në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë, sepse nuk e ndryshoi Kornizën për të përfshirë një të një shkallë të ngjashme mbikëqyrjeje gjyqësore për incizimet e atyre intervistave.<sup>251</sup>

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

95. Fillimisht, Paneli vëren se, megjithëse vuri në dukje “formulimin shumë të përgjithshëm” të pikës së tetë të Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ajo kishte të bënte me pyetjen nëse masat e incizimit dhe të nxjerrjes së materialit janë në përputhje me rregullat 106 dhe/ose 111(1) të Rregullores.<sup>252</sup> Gjykatësi i Procedurës

---

<sup>247</sup> Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 15. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 16.

<sup>248</sup> Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 16 (theksimi si në origjinal).

<sup>249</sup> Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 17. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 15-16.

<sup>250</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 12-13.

<sup>251</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 14-15, 17.

<sup>252</sup> Vendimi mbi Lejen për Apelim, para. 46.

Paraprake e kufizoi pikën e miratuar për apelim në pjesët konkrete të Vendimit të Kundërshtuar ku diskutohen posaçërisht këto dy dispozita.<sup>253</sup> Paneli vëren se në Pikën C, Thaçi bën parashtrime lidhur me rregullën 104(5) të Rregullores.<sup>254</sup> Duke rikujtuar se Paneli mund të shqyrtojë argumente në qoftë se ato janë ngushtësisht të lidhura me pikën e miratuar për apelim,<sup>255</sup> Paneli konstaton se kundërshtimi i Thaçit në lidhje me rregullën 104 të Rregullores lidhet ngushtë me pikën e miratuar, sikurse u përkufizua nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,<sup>256</sup> dhe për këtë arsye do ta marrë në shqyrtim.

96. Sa i takon parashtrimin të parë të Thaçit se në Rregullore nuk përcaktohet një sistem për nxjerrjen e materialeve nga Mbrojtja në fazën e procedurës paraprake apo gjatë fazës së paraqitjes së provave nga Prokuroria në gjykim,<sup>257</sup> Paneli vëren se, sipas rregullës 119 të Rregullores, Mbrojtja vërtet nuk ka detyrimin të paraqesë prova dhe, vetëm nëse vendos të paraqesë prova, aktivizohen detyrimet sipas rregullës 104 të Rregullores. Megjithatë, Paneli vëren gjithashtu se rregullat 104(5) dhe 119(1) të Rregullores parashikojnë vetëm afatet *më të vonshme* brenda të cilëve duhen kryer këta hapa proceduralë, por e lë në diskrecionin e panelit përkatës që të caktojë afate më të hershme. Po ashtu, kjo nuk do të thotë se sipas kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, nuk është e mundshme që Mbrojtjes t'i caktohen disa detyrime për nxjerrje të materialeve në një fazë më të hershme.<sup>258</sup> Krahas kësaj, në Rregullore

---

<sup>253</sup> Pra, Vendimi i Kundërshtuar, para. 155-157. Shih Vendimin mbi Lejen për Apelim, para. 46.

<sup>254</sup> Shih Apelin e Thaçit, para. 48-52.

<sup>255</sup> Shih, p.sh., IA013/F00012, Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve, 20 maj 2022, para. 34 dhe jurisprudenca e cituar aty.

<sup>256</sup> Paneli vëren gjithashtu se titulli i Pikës së Tetë të Thaçit i referohet drejtpërdrejt rregullës 104 të Rregullores.

<sup>257</sup> Shih Apelin e Thaçit, para. 47-48.

<sup>258</sup> Shih, p.sh., *Lubanga* Decision on Disclosure by Defence, para. 31 (ku Trupi Gjykes i GJPN-së njohu mundësinë, sipas kornizës së Statutit të Romës, për t'i vendosur të akuzuarit detyrime për nxjerrje të informacionit “paraprakisht dhe në rrethana të përshtatshme”); *Lubanga* Decision on Contacts with Defence Witnesses, para. 59 (ku Trupi Gjykes i GJPN-së konstatoi se të akuzuarit duhej t'i jepnin Prokurorisë “hollësi shtesë specifike” në lidhje me dëshmitarë të mbrojtjes, për ta ndihmuar në hetimet e saj).

parashikohen disa raste të nxjerrjes së materialeve në procedurë paraprake për Mbrojtjen në rrethana të veçanta.<sup>259</sup>

97. Gjithashtu, Paneli vëren se rregulla 104(5)(b) e Rregullores ka të bëjë vetëm me nxjerrjen e deklaratave të dëshmitarëve të *Mbrojtjes*. Duke pasur parasysh se Korniza, për nga vetë përkufizimi, rregullon vetëm kontaktet me dëshmitarët e palës *kundërshtare*, nxjerrja nga Mbrojtja e intervistave me dëshmitarët e ZPS-së të kryera sipas Kornizës nuk vë në lëvizje zbatimin e rregullës 104(5)(b) të Rregullores dhe, për këtë arsye nuk përbën shkelje të kësaj rregulle, pavarësisht nëse Mbrojtja në fund vendos të paraqesë prova ose jo. Në lidhje me atë se Korniza do të përfshinte kushte shtesë për nxjerrjen e materialit, Paneli është i mendimit se sistemi i nxjerrjes së materialeve i Dhomave të Specializuara nuk përjashton nxjerrje më të hershme nga ana e Mbrojtjes dhe, rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e shpërdoroi diskrecionin e tij. Gjithashtu, duke pasur parasysh se kushtet shtesë për nxjerrjen e materialit do të zbatoheshin njësoj për të dyja palët, kjo nuk përbën zhvendosje të detyrimit të vërtetimit, sidomos ngaqë Mbrojtja nuk është e detyruar t'i kryejë këto intervista dhe ngaqë kjo nuk ka asnjë ndikim në vendimin e akuzuarve nëse do të paraqesin ose jo prova të Mbrojtjes.<sup>260</sup>

98. Në lidhje me skenarin e paraqitur nga Thaçi, që, pas intervistës me Mbrojtjen, ZPS-ja vendos të mos e thërrasë dëshmitarin që fillimisht e kishte në Listë, dhe më pas Mbrojtja e thërret atë si dëshmitar të vetin pavarësisht se ZPS-ja tashmë ishte në zotërim të deklaratës së dëshmitarit, Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se ky argument është hamendësues.<sup>261</sup> Gjithashtu, megjithëse Thaçi

---

<sup>259</sup> Shih, p.sh., rregullën 95(5) të Rregullores (ku përcaktohet se Mbrojtja duhet të informojë ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë brenda një afati të vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake) dhe rregullën 104(1) të Rregullores (ku përcaktohet se Mbrojtja duhet t'i japë njoftim të hollësishëm alibie ZPS-së “në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes sipas rregullës 124 [të Rregullores]”).

<sup>260</sup> *Contra* Apeli i Thaçit, para. 48-49. Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 144.

<sup>261</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 159. *Contra* Apeli i Thaçit, para. 50-51.

evidenton një situatë e cila mund të lindë në mënyrë hipotetike,<sup>262</sup> Paneli konstaton se kjo nuk do ta cenonte integritetin e Kornizës dhe as nuk do të sugjeronte shkelje të vetvetishme të sistemit të nxjerrjes së materialeve në Dhomat e Specializuara.<sup>263</sup> Gjithsesi, Paneli rikujton konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se, nëse përlligjet nga rrethanat, Mbrojtja ka mundësinë të bëjë kërkesë për mjet juridik të përshtatshëm.<sup>264</sup>

99. Rrjedhimisht, Paneli është bindur se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gaboi që konstatoi se Korniza nuk është në shkelje të rregullës 104 të Rregullores dhe sistemit të nxjerrjes së materialeve në Dhomat e Specializuara në përgjithësi.<sup>265</sup>

100. Sa i takon Pikës 2 të Apelit të Selimit, Paneli vëren se, megjithëse Selimi tani argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake shpërdoroi diskrecionin e tij sepse nuk mori në shqyrtim masa më pak kufizuese, dhe se Zyra Administrative duhej të ishte ngarkuar me ruajtjen e intervistave të incizuara të mbajtura nën vulë,<sup>266</sup> Selimi nuk ia paraqiti këtë propozim për ndryshim të Kornizës Gjykatësit të Procedurës Paraprake, as në parashtrimet e tij me shkrim, as në parashtrimet me gojë.<sup>267</sup> Rrjedhimisht, ky argument po ngrihet për herë të parë në apel. Duke qenë se mund të ishte ngritur në mënyrë të arsyeshme në shkallë të parë dhe trajton aspektin e

<sup>262</sup> Shih Apelin e Thaçit, para. 51. Sa u takon Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit në të cilat ai është mbështetur në apel, Paneli rikujton se nuk do t'i shqyrtojë këto argumente sepse ato nuk u shqyrtuan nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ngaqë ishin pa bazë ligjore apo autorizim. Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 110; Apeli i Thaçit, para. 52, poshtëshënimi 50, ku u referohet Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit, para. 10; Apeli i Thaçit, para. 50, poshtëshënimi 47, ku i referohet Apelit të Thaçit, para. 30, poshtëshënimi 39, ku u referohet Parashtrimeve Plotësuese të Thaçit, para. 10. Shih edhe Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 60.

<sup>263</sup> *Contra* Apeli i Thaçit, para. 50 (ku pretendohet shkelje e rregullës 104(5) të Rregullores).

<sup>264</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 159.

<sup>265</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 159. Lidhur me argumentin e Thaçit se Korniza shkel mbrojtjen e informacionit të privilegjuar sipas rregullës 111 të Rregullores sepse u nxjerr informacion të mbrojtur ZPS-së dhe trupit gjyqësor, Paneli rikujton konstatimin e tij të mësipërm se Korniza nuk e bën një shkelje të tillë. Shih Apelin e Thaçit, para. 53, 55. Shih më lart, para. 68.

<sup>266</sup> Apeli i Selimit, para. 4, 28, 37-41, 43, 45-46, 47(ii).

<sup>267</sup> Për shembull, megjithëse Selimi argumenton se ndikimi i zbatimit të kësaj mase në burimet e Zyrës Administrative me gjasë do të ishte minimal, Zyra Administrative nuk është shprehur asnjëherë në lidhje me realizueshmërinë dhe ndikimin e kësaj mase në shkallë të parë. Shih Apelin e Selimit, para. 43.

burimeve të Zyrës Administrative, rrëzimi i menjëhershëm i saj është i përligjur.<sup>268</sup> Rrjedhimisht, Paneli nuk do t'i shqyrtojë argumentet e Selimit në këtë aspekt.<sup>269</sup> Gjithsesi, Paneli i Apelit rikujton konstatimet e tij se, në kuadër të nenit 39(1) dhe (11) të Ligjit, nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kërkohet të kryente vlerësim nëse ishin të disponueshme masa më pak kufizuese.<sup>270</sup>

101. Për këto arsye, rrëzohen Pika C e Apelit të Thaçit dhe Pika 2 e Apelit të Selimit.

#### D. KËRKESA PËR EFEKT PEZULLUES

102. Thaçi bën kërkesë për efekt pezullues të Vendimit të Kundërshtuar në bazë të rregullës 171 të Rregullores, me pretendimin se zbatimi ndërkohë i Kornizës do të ishte i pakthyeshëm, sepse hetimet e Mbrojtjes gjatë fazës së procedurës paraprake “nuk mund të ribëhen” dhe zbatimi do të binte ndesh me qëllimin e apelit të tij.<sup>271</sup> Rrjedhimisht, ai i kërkon Panelit të Apelit të urdhërojë pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të Vendimit të Kundërshtuar.<sup>272</sup>

103. Mbrojtësi i Viktimave dhe ZPS-ja kundërshtojnë kërkesën e Thaçit për efekt pezullues.<sup>273</sup> Mbrojtësi i Viktimave thekson se në një situatë të tillë mund të kontaktohen nga Mbrojtja drejtpërdrejt dëshmitarë me status të dyfishtë, që do të ishte në shkelje të detyrimit të Dhomave të Specializuara për të siguruar mirëqenien psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve me status të dyfishtë sipas nenit 23(1) të Ligjit.<sup>274</sup> ZPS-ja parashtron se kjo mund të dëmtojë në mënyrë të

<sup>268</sup> Shih, p.sh., Vendimi mbi Apelin e Haradinajt, para. 29, 38; IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit në lidhje me Lirimën e Përkohshëm, 30 prill 2021, para. 51.

<sup>269</sup> Lidhur me parashtrimet e Selimit se Mbrojtjes do t'i duhet të peshojë rrezikun e daljes së provave inkriminuese dhe të nxjerrjes së informacionit palës kundërshtare nga njëra anë kundrejt detyrimit të Mbrojtjes për t'u përgatitur në mënyrë të plotë provat dhe argumentet e saj, nga ana tjetër, Paneli rikujton se pretendime të ngjashme janë trajtuar dhe rrëzuar gjatë në këtë vendim. Shih më lart, para. 57, 79-83. Shih Apelin e Selimit, para. 35-38.

<sup>270</sup> Shih më lart, para. 32.

<sup>271</sup> Apeli i Thaçit, para. 56. Shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 18.

<sup>272</sup> Apeli i Thaçit, para. 57; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 21.

<sup>273</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 65; Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 81-83.

<sup>274</sup> Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 64-68.



pandreqshme interesat e viktimave dhe të ZPS-së “duke qenë se gjatë kohës kur Korniza është e pezulluar, mund të ndodhë ndonjë prej dëmeve që synohen të parandalohen prej saj”.<sup>275</sup> Duke theksuar se Thaçi është i vetmi i akuzuar që e bën këtë kërkesë, ZPS-ja parashtron gjithashtu se ai nuk jep prova në mbështetje të pretendimit të tij dhe se Korniza nuk vendos asnjë kufizim që do të ndikonte në mundësinë e tij për të intervistuar dëshmitarë që nuk janë njoftuar.<sup>276</sup>

104. Thaçi kundërpërgjigjet se shqetësimet e Mbrojtësit të Viktimave lidhur me dëshmitarët me status të dyfishtë nuk kanë bazë të arsyeshme, sepse që prej kohës kur Mbrojtja ka filluar hetimet, nuk është ngritur asnjë pretendim për ndonjë incident.<sup>277</sup> Ai shton se, në qoftë se Paneli i Apelit ka ndër mend t’i pranojë ato argumente, ai kërkon, si alternativë, pezullimin e zbatimit të Kornizës në lidhje me dëshmitarët që Mbrojtja i ka kontaktuar përpara hyrjes në fuqi të Kornizës.<sup>278</sup>

105. Paneli rikujton se sipas rregullës 171 të Rregullores, efekti pezullues miratohet vetëm si masë e posaçme. Për arsyet e shpjeguara me hollësi më lart, Paneli konstaton se Korniza është vendosur sipas rregullave, është e përligjur për t’u dhënë zgjidhje qëllimeve të ndryshme të saj, dhe nuk përbën shkelje joproporcionale të të drejtave të të akuzuarve.<sup>279</sup> Në këto rrethana, Paneli është bindur se Mbrojtja ka qenë dhe vazhdon të jetë në gjendje t’i kryejë hetimet edhe në kuadër të zbatimit të Kornizës dhe konstaton se ajo nuk ka dhënë prova në mbështetje të pretendimit se kryerja e përgatitjeve për gjykim është cenuar ose “dëmtuar në mënyrë të pariparueshme” si rezultat. Gjithashtu, Paneli rikujton se Korniza ka një objektiv mbrojtës dhe mban parasysh ndikimin e mundshëm negativ që mund të ketë pezullimi i Kornizës tek dëshmitarët, përfshirë dëshmitarët me status të dyfishtë. Paneli konstaton se Thaçi nuk ka dhënë prova në mbështetje të pretendimit të tij dhe nuk ka demonstruar se

---

<sup>275</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 83.

<sup>276</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 82.

<sup>277</sup> Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 19.

<sup>278</sup> Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 20-21.

<sup>279</sup> Shih më lart, para. 35, 57, 68, 78, 83, 99.

zbatimi i Vendimit të Kundërshtuar dhe i Kornizës mund të bjerë ndesh me qëllimin e apelit ose të shkaktojë pasoja të pakthyeshme. Rrjedhimisht, kërkesa për efekt pezullues rrëzohet.

## V. VENDIM

106. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**RRËZON** Apelet;

**URDHËRON** të akuzuarit dhe ZPS-në të paraqesin versione të redaktuara publike të parashtrimeve të protokolluara në lidhje me apelin që përmenden në paragrafin 11, ose të bëjnë të ditur me anë të një parashtrimi, nëse këto parashtrime mund të riklasifikohen si publike brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit të këtij vendimi; dhe

**URDHËRON** Zyrën Administrative të bëjë riklasifikimin e parashtrimeve të përmendura në paragrafin 11, pasi të akuzuarit dhe ZPS-ja të bëjnë të ditur se ato mund të riklasifikohen.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,**  
**Kryegjykatëse**

E enjte, 27 dhjetor 2022

Hagë, Holandë